



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 60

Tiranë – E martë, 21 prill 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.16, datë 10.4.2015	
Me objekt: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 7 të ligjit nr. 101, datë 31.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”.	
Pezullimi i zbatimit të dispozitave të ligjit objekt i kësaj kërkesë deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.....	2627
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.17, datë 10.4.2015	
Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-55, datë 22.1.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	2639
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.4.2015	
Me objekt shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 713, datë 4.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 44, datë 26.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.....	2648
Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ardjan Gryka.....	2654



VENDIM

Nr.16, datë 10.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar i	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “

me sekretare Blerina (Çinari) Basha, në datën 6.11.2014 mori në shqyrtim në seancë plenare me dyer të hapura çështjen me nr. 49/17 Akti, që i përket:

KËRKUES: Presidenti i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga zonja Ledina Mandia dhe zoti Ilia Jolldash.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar në gjykim nga zoti Alban Brati.

KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar në gjykim nga zoti Artur Metani.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 7 të ligjit nr. 101, datë 31.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”.

Pezullimi i zbatimit të dispozitave të ligjit objekt i kësaj kërkesë deri në hyrjen në fuqi të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 7, 94, 131/a, 134/1/a dhe 147/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenet 45 dhe 49/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fatos Lulo; përfaqësuesit e kërkuarit, që kërkojnë pranimin e kërkesës; përfaqësuesit e subjekteve të interesuara, që kërkojnë rrëzimin e kërkesës, dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*) në datën 31.7.2014 miratoi ligjin nr. 101 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” (të ndryshuar) (*këtu e në vijim ligji nr. 101, datë 31.7.2014*). Ndër të tjera, ky ligj ka sjellë ndryshime edhe për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Kështu sipas nenit 7 të këtij ligji “*Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një zëvendëskryetar*”.

2. Ligji nr. 101, datë 31.7.2014 është rikthyer për rishqyrtim në Kuvend me dekretin nr. 8679, datë 15.8.2014 të Presidentit të Republikës dhe me vendimin nr. 58, datë 1.9.2014, Kuvendi ka votuar për rrëzimin e këtij dekreti. Ligji është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 01.09.2014 dhe sipas nenit 15 të tij (*ku parashikohet hyrja në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare*), ka hyrë në fuqi në datën 16.9.2014.

II

3. **Kërkuesi,** Presidenti i Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me kërkesën për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 7 të ligjit nr. 101, datë 31.7.2014, duke pretenduar se:

3.1 Ndryshimi që sjell neni 7 për propozimin e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, *cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve*. Duke pasur të qartë rolin e KLD-së në garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, Kushtetuta i ka lënë mundësi Presidentit të Republikës që të propozojë një kandidat për zëvendëskryetar nga të gjithë anëtarët e KLD-së.

3.2 Neni 7 kapërcen parashikimet kushtetuese si në formë edhe në përmbajtje, dhe si i tillë *cenon parimin e hierarkisë së normave*. Neni 147, paragrafi 3, i Kushtetutës nuk përmban elementet e një norme referuese, sepse sipas këtij parashikimi nuk i delegohen kompetenca ligjvënësit të zakonshëm për të përcaktuar mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit.

4. Kërkuesi pretendon pezullimin e zbatimit të ligjit nr. 101, datë 31.7.2014, me argumentin se mund të sjellë pasoja, që prekin jo vetëm interesat shtetërore, por edhe interesat e individit. Zbatimi i



këtij ligji potencialisht krijon situatën e dobësimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë duke cenuar rëndë pavarësinë e gjyqësorit, si dhe u heq të drejtën anëtarëve të KLD-së, të zgjedhur nga vet gjyqtarët, për t'u propozuar në postin e zëvendëskryetarit.

5. **Subjekti i interesuar**, Kuvendi, në parashtrimet drejtuar Gjykatës, vlerëson se kërkesa është e pabazuar dhe duhet rrëzuar për këto arsye:

5.1 Referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesi, në vlerësimin e Kuvendit, kjo çështje bie në fushën e veprimit të shkronjës “ç” të nenit 131 të Kushtetutës, e cila parashikon të drejtën e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi mosmarrëveshjet e kompetencës ndërmjet pushteteve dhe jo në fushën e veprimit të shkronjës “a” të këtij neni, ku parashikohet e drejta e Gjykatës për të vendosur për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën.

5.2 Bazuar në Kushtetutë dhe në ligjin specifik nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, rezulton qartësisht se zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë përbën ushtrim të një veprimtarie apo funksion shtetëror me kohë të plotë. Rrjedhimisht, bazuar në nenet 103 dhe 143 të Kushtetutës, nga pikëpamja kushtetuese ky funksion (*kupto: zëvendëskryetar i KLD-së*) është i papajtueshëm me funksionin e ministrit dhe atë të gjyqtarit. Për këtë arsye, edhe pse Kushtetuta në nenin 147/2 të saj parashikon si kompetencë kushtetuese të Presidentit të drejtën për të propozuar Zëvendëskryetarin e KLD-së nga radhët e tij, të gjithë presidentët në detyrë në kohë të ndryshme (*përfshirë edhe vetë kërkuesin*), për të shmangur këtë papajtueshmëri kushtetuese, e kanë ushtruar këtë kompetencë duke propozuar në këtë funksion një nga anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi.

5.3 Referuar jurisprudencës kushtetuese (*vendimit nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës Kushtetuese*) dhe vetë parashikimeve kushtetuese për papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit, Kuvendi vlerëson se zëvendëskryetari nuk mund të propozohet nga radhët e 9 anëtarëve që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, pasi qenia gjyqtar nuk pajtohet me veprimtarinë dhe funksionin shtetëror me kohë të plotë që ushtrohet prej zëvendëskryetarit të KLD-së. Gjithashtu, edhe nëse kjo papajtueshmëri kushtetuese formalisht do të zgjidhet prej tij me dorëheqje nga detyra e gjyqtarit, atëherë ky anëtar jo vetëm do të humbiste

cilësinë e tij si gjyqtar, pasi nuk mund të punonte efektivisht si i tillë, por në çdo rast kjo do të zhbalkanconte formulën e përfaqësimit të pushtetit gjyqësor dhe atij legjislativ në KLD-së, përcaktuar në nenin 147/1 të Kushtetutës, formulë që në vetvete garanton parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve.

5.4 Në lidhje me kërkesën për pezullim, subjekti i interesuar Kuvendi, në mbështetje të konsideratave të mësipërme për themelin e kërkesës, vlerëson se për sa kohë zgjidhja që parashikon dispozita ligjore, objekt kërkesë, është jo vetëm zgjidhja e vetme kushtetuese, por edhe zgjidhja aktuale në fuqi, nuk ka asnjë mundësi që ky ndryshim ligjor të sjellë pasoja që mund të prekin interesa shtetërore, shoqërore ose të individëve.

6. **Subjekt i interesuar**, Këshilli i Ministrave, parashitroi para Gjykatës në mënyrë të përmbledhur se:

6.1 Sipas Kushtetutës funksioni i zëvendëskryetarit të KLD-së është një funksion kushtetues me kohë të plotë. Kjo veçori rrjedh nga formulimi i nenit 147/3 të Kushtetutës, sipas të cilit zëvendëskryetari i KLD-së është i ngarkuar të organizojë veprimtarinë e përditshme të këtij institucioni.

6.2 Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 22.05.2006 e ka orientuar ligjvënësin për mosdeformimin e formulës kushtetuese të KLD-së dhe ruajtjen e balancës ndërmjet pushteteve, në veçanti për sa i takon mosndryshimit të numrit të gjyqtarëve, si dhe mosshndërrimit të tyre në funksionarë me kohë të plotë, gjë që i shmang ata nga kryerja e detyrës së gjyqtarit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për kërkesën për pezullim të dispozitës ligjore objekt shqyrtimi

7. Gjykata mori paraprakisht në shqyrtim kërkesën për pezullimin e dispozitës ligjore objekt shqyrtimi, të paraqitur nga kërkuesi, dhe vlerësoi se kjo kërkesë nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga neni 45 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”. Për rrjedhojë, Gjykata në datën 9.10.2014 ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë si të pabazuar.

B. Për legjitimitimin e kërkuesit



8. Bazuar në nenin 134/1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe nenin 49/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, Presidenti i Republikës ushtron të drejtën për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit ose akteve të tjera normative me Kushtetutën. Kushtetuta ka pranuar se interesi i bartësve të funksionit publik, që i është njohur Presidentit të Republikës, Kryeministrit, një të pestës së deputetëve dhe Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, me qëllim mbrojtjen e sistemit normativ dhe të parimeve shtetformuese, si konstitucionalizmi, shteti i së drejtës, demokracia, dinjiteti njerëzor, barazia sociale etj. nuk mund të kushtëzohet (*shih vendimin nr. 18, datë 29.7.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa më sipër, kërkuesi pretendon se ligji bie ndesh me nenin 147/3 të Kushtetutës, pasi cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, si dhe hierarkinë e normave, si rrjedhim ai legjitimohet t’i drejtohet kësaj Gjykate.

9. Neni 131, paragrafi “a” i Kushtetutës parashikon se Gjykata Kushtetuese vendos për papajtueshmërinë e ligjit me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, siç parashikohet në nenin 122. Në këtë kuptim, akti i kundërshtuar është ligji nr. 101, datë 31.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar” dhe si i tillë plotëson kushtet për t’u marrë në shqyrtim nga Gjykata.

10. Bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, kërkesat në Gjykatën Kushtetuese, për shqyrtimin e pajtueshmërisë së ligjit me Kushtetutën, mund të paraqiten brenda 3 vjetëve nga hyrja në fuqi e tij. Gjykata konstaton se ligji, i cili pretendohet se është antikushtetues, ka hyrë në fuqi në datën 16.09.2014 dhe se kërkesa në Gjykatë është paraqitur në datën 22.9.2014, pra kërkuesi ka respektuar afatin 3-vjeçar për këtë qëllim.

Për të gjitha këto arsye, Gjykata vlerëson se kërkesa i plotëson kriteret formale për t’u marrë në shqyrtim.

C. Për pretendimin se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve

11. Kërkuesi pretendon se dispozita ligjore objekt kërkese bie ndesh me nenet 7 dhe 147/3 të Kushtetutës, pasi kufizon kompetencën e Presidentit të Republikës, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për të propozuar si zëvendëskryetar cilindo nga anëtarët e tij, të parashikuar në nenin 147/3 të Kushtetutës. Ky kufizim cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve për sa kohë ka një tendencë të maxhorancës parlamentare që menaxhimin e autoritetit që garanton pavarësinë e gjyqësorit ta realizojë nga të zgjedhurit e Kuvendit, duke mos i lënë KLD-së asnjë mundësi tjetër zgjedhjeje. Gjithashtu, rregulli i ri shuan pozitën e barabartë të anëtarëve të KLD-së, në kundërshtim me Kushtetutën, e cila nuk ka dashur të bëjë asnjë dallim midis anëtarëve të zgjedhur që marrin pjesë në të.

12. Subjektet e interesuara, Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, prapësuan se ndryshimi i bërë në ligj për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së nuk e deformon formulën kushtetuese të KLD-së dhe ruan balancën ndërmjet pushteteve, veçanërisht për sa i takon mosndryshimit të numrit të gjyqtarëve efektivë në përbërjen e këtij organi.

13. Gjykata merr në analizë pretendimin e kërkuesit, duke evidentuar më parë parimet dhe standardet kushtetuese që lidhen me ndarjen dhe balancimin ndërmjet pushtetit legjislativ, ekzekutiv e atij gjyqësor, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, statusin dhe veprimtarinë e anëtarësisë së tij, etj. Gjykata rithekson rëndësinë thelbësore të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve si një parim i shtetit të së drejtës. Parimi i ndarjes dhe i balancimit të pushteteve, si një nga bazat kryesore të shumë kushtetutave moderne, i parashikuar edhe në nenin 7 të Kushtetutës, u jep mundësi të tria degëve të qeverisjes (legjislativit, ekzekutivit e gjyqësorit) jo vetëm të respektojnë njëri-tjetrin në ushtrimin e funksioneve të tyre, por edhe të kontrollohen e ndihmohen në mënyrë të ndërsjellë, me qëllim funksionimin sa më mirë të sistemit të qeverisjes. Ky parim, duke mos qenë qëllim në vetvete, ndihmon që pushteti të shpërndahet në disa mbajtës me funksione e detyra të ndryshme për të siguruar reciprokisht një drejtësi më të madhe në ushtrimin e tij. Nga ana tjetër, parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve ndihmon, gjithashtu, edhe në bashkëveprimin e mbajtësve të pushteteve, duke



siguruar shkallë garancie dhe siguri më të lartë në marrjen e vendimeve të drejta dhe të peshuara. Prandaj, parimi i ndarjes e balancimit të pushteteve, pavarësisht nga alternimi i forcave politike në pushtet, duhet të mbetet mbizotërues (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 19, datë 3.5.2007*).

14. Jurisprudenca kushtetuese, në respekt të zbatimit të parimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve dhe të parimit të shtetit të së drejtës, ka theksuar se pavarësia e gjyqësorit duhet kuptuar si *pavarësi thelbësore* (tagër e gjykatave për të dhënë vendime me paanësi dhe pa u ndikuar nga interesat e ndonjë dege tjetër të pushtetit) dhe si *pavarësi strukturore*, që kërkon parashikimin në Kushtetutë të institucionit që realizon emërimet dhe shkarkimet e gjyqtarëve (*shih vendimin nr. 25, datë 5.12.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Sipas Kushtetutës, pushteti gjyqësor përbën një organizim autonom dhe të pavarur nga çdo pushtet tjetër. Autonomia i përket strukturës organizative. Kjo realizohet përkundrejt pushtetit ekzekutiv, në kuptimin që pavarësia e gjyqësorit do të komprometohej nëse vendimmarrja progresive e karrierës së gjyqtarëve apo statusit të tyre në përgjithësi do t'i atribuohet pushtetit ekzekutiv. Kushtetuta, në fakt, i ka atribuuar një organi të qeverisjes autonome administrimin e personelit të gjyqësorit (*kupto: gjyqtarët*), transferimin, promovimin, masat disiplinore etj: Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili është edhe garant i pavarësisë së gjyqësorit. Autonomia realizohet edhe përkundrejt pushtetit legjislativ, në kuptimin që gjyqtarët u nënshtrohen vetëm ligjeve. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se parashikimet kushtetuese për ndarjen e pushteteve në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, për pavarësinë, paanshmërinë dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve, për sanksionimin në ligje organike të organizmit të gjykatave, kompetencat e tyre në procedurat gjyqësore, përkufizojnë statusin kushtetues të gjyqtarëve si dhe pozicionojnë drejtësinë si një degë e mëvetësishme e pushtetit, e pavarur dhe e paanshme.

16. Parimet e mësipërme kushtetuese gjejnë shprehjen e tyre më të drejtpërdrejtë në nenin 145 të Kushtetutës, ku deklarohet se gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve (*neni 145, pika 1 i Kushtetutës*). Roli i gjyqtarit dhe gjykatave në një shtet të së drejtës është që

ndërsa ushtrojnë funksionin e drejtësisë, ata duhet të sigurojnë zbatimin e normave të shprehura në Kushtetutë, të ligjeve dhe të akteve të tjera ligjore, të garantojnë shtetin e së drejtës dhe të mbrojnë të drejtat dhe liritë e njeriut. Në kuadrin e parimit të kontrollit dhe balancës ndërmjet pushteteve, varësia absolute e gjyqtarit ndaj ligjit është kushti dhe legjitimimi i kësaj pavarësie (*shih vendimin nr. 20, datë 09.07.2009*).

17. Pavarësia e gjyqtarëve, si garanci efektive për të drejtat e qytetarëve, përforcohet edhe me përmbajtjen e nenit 147 të Kushtetutës, nga përmbajtja e të cilit “qeverisja” e gjyqësorit i është lënë në kompetencë Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Sipas kësaj dispozite, ky organ kushtetues, i pavarur nga legjislativi dhe ekzekutivi, vendos, ndër të tjera, edhe për transferimin e gjyqtarëve të shkallës së parë dhe të apelit, për përgjegjësinë disiplinore të tyre, si dhe i propozon Presidentit të Republikës për emërim kandidataturat për gjyqtarë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë është organi kushtetues i pozicionuar në majën e piramidës organizative të pushtetit gjyqësor. Për të realizuar vetëqeverisjen e gjyqësorit, Këshilli i Lartë i Drejtësisë përbëhet në shumicën e tij nga gjyqtarë, të cilët, duke ushtruar funksionet e tyre si të tillë, realizojnë lidhjen e këtij Këshilli me korpusin gjyqësor. Frymën e korporatës (vetëqeverisjes) në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, kushtetutëbërësi e ka futur me qëllim të caktuar, për ta bërë gjykatën të pavarur nga ndërhyrjet e legjislativit dhe të ekzekutivit (*shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006*).

18. Referuar ndryshimeve ligjore të kundërshtuara si të papajtueshme me Kushtetutën nuk rezulton të ketë ndryshuar formula e përbërjes së KLD-së, përfaqësimi i gjyqësorit në këtë organ plural mbetet i pacenuar, si në drejtim të numrit, ashtu edhe lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me trupën gjyqësore (në cilësinë e gjyqtarit). Nga ana tjetër, referuar ligjit për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe akteve të brendshme rregullatore, zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ushtron më së shumti detyra që i përkasin sferës administrative dhe në këtë kuptim nuk gëzon pozitë dominuese në veprimtarinë e KLD-së, që lidhet me çështjen e administrimit të gjyqësorit.

19. Kjo përforcohet edhe nga fakti se ligji organik për Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk i jep peshë të diferencuar votës së zëvendëskryetarit në



vendimmarrjen e KLD-së për çështjet që lidhen me emërimet, transferimet, procedimet disiplinore për gjyqtarët etj. Parashikimet ligjore konsistojnë vetëm në vendosjen e kufizimeve dhe jo në përcaktimin e privilegjeve për procesin vendimmarrës. Kështu, të vetmet kufizime që imponon ligji lidhen me pjesëmarrjen e kushtëzuar në votim në rastet e pengesës ligjore apo në raste të tjera që lidhen me mospjesëmarrjen e Ministrisë të Drejtësisë, në rastet e procedimeve disiplinore të nisura prej tij, apo Presidentit të Republikës dhe në rastet e propozimeve për emërim të gjyqtarëve.

20. Për më tepër Gjykata vëren se modeli i zgjedhjes së zëvendëskryetarit të KLD-së, nga radhët e të zgjedhurve nga parlamenti nuk është i panjohur në sisteme të tjera ligjore. Sipas nenit 104 të kushtetutës italiane “Këshilli zgjedh një zëvendëspresident ndërmjet anëtarëve të zgjedhur nga Parlamenti”. Konform këtij neni kushtetues, ky rregullim gjen pasqyrim edhe në legjislacionin e zakonshëm për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (*ligji nr. 159, datë 24.3.1958, ndryshuar me ligjet nr. 695/1975 e 44/2002*).

21. Për të gjitha këto konsiderata, Gjykata vlerëson se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së nga anëtarët e zgjedhur nga parlamenti, nuk paraqet element të cenimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

D. Për pretendimin se neni 7 i ligjit nr. 101, datë 31.7.2014 cenon parimin e hierarkisë së normave

22. Kërkuesi pretendon se neni 7 i ligjit nr. 101, datë 31.7.2014 kapërcen parashikimet kushtetuese si në formë, edhe në përmbajtje dhe si i tillë cenon parimin e hierarkisë së normave. Neni 147, paragrafi 3, i Kushtetutës nuk përmban elementet e një norme referuese, sepse sipas këtij parashikimi nuk i delegohen kompetenca ligjvënës të zakonshëm për të përcaktuar mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit të KLD-së.

23. Gjykata, paraprakisht, evidenton se në gjykime të kësaj natyre orientohet nga parimi i prezumimit të kushtetutshmërisë së ligjit të kundërshtuar. Ky parim është njohur e konsoliduar në doktrinë kushtetuese dhe ka gjetur pasqyrim edhe në jurisprudencën e Gjykatës si një parim bazë i gjykimit kushtetues. (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 25.7.2008, nr. 37, datë 13.6.2012 dhe nr. 14 datë 17.4.2013*).

24. Në nenin 4, si dhe në preambulën e Kushtetutës deklarohet parimi i shtetit të së drejtës. Ky parim është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai është një normë e pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues. Ky parim nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës, që lidhen me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues, janë parimi i ndarjes së pushteteve dhe, i lidhur me këtë parim, ai i pavarësisë së gjyqësorit, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës dhe parimi i sigurisë juridike (*shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 11.7.2006 dhe nr. 34, datë 20.12.2005*).

25. Një shtet i së drejtës orientohet drejt hierarkisë së normave juridike, prandaj hierarkia, statusi dhe efekti i normave ligjore janë të parashikuara në Kushtetutë. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010*).

26. Në dispozitën ligjore objekt shqyrtimi, parashikohet se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një zëvendëskryetar”. Në nenin 147/3 të Kushtetutës parashikohet se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kryeson mbledhjet e tij në mungesë të Presidentit të Republikës”.

27. Gjykata vëren se dispozita objekt gjykimi, në raport me Kushtetutën, në pamje të parë, të krijon idenë e një ndryshimi në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, duke e ngushtuar këtë zgjedhje vetëm tek 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi.

28. Në lidhje me këtë pretendim subjektet e interesuara (*Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave*) prapësuan se nuk është rregullimi i ri ligjor ai që e



sjell këtë ndryshim, por kjo është rrjedhojë e interpretimit sistematik të vetë nenit 147 të Kushtetutës. Zëvendëskryetari i KLD-së është një funksion kushtetues me kohë të plotë i ngarkuar me detyra për organizimin e veprimtarisë së përditshme KLD-së. Si rrjedhim, ai nuk mund të zgjidhet nga anëtarët *ex officio* të KLD-së, për shkak të papajtueshmërisë për të mbajtur njëkohësisht dy funksione shtetërore me kohë të plotë. Për anëtarët që vijnë nga gjyqësori, 9 gjyqtarët, ky detyrim rrjedh nga jurisprudenca kushtetuese, e cila u reflektua nga ligjvënësi në hartimin e ndryshimeve ligjore përkatëse për zgjedhjen e zëvendëskryetarit.

29. Gjykata vëren se Kushtetuta në nenin 147/3 parashikon si funksion kryesor të zëvendëskryetarit të KLD-së organizimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në zbatim të neneve 6 dhe 81, pika 2, të Kushtetutës, ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, i cili parashikon në mënyrë të detajuar detyrat e zëvendëskryetarit të KLD-së në përbushje të funksioneve të tij kushtetuese. Konkretisht në nenin 13 të këtij ligji parashikohet: “Zëvendëskryetar i KLD-së i ushtron funksionet e tij me kohë të plotë dhe ushtron këto detyra: a) Kujdeset për veprimtarinë normale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. b) Organizon dhe drejton veprimtarinë e Inspektoratit dhe të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. c) Ndjek veprimet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për verifikimin e ankesave dhe të të dhënave për gjyqtarët dhe për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Këshilli, në rastet e procedimeve disiplinore të filluara nga Ministri i Drejtësisë. ç) Organizon punën përgatitore për rendin e ditës dhe për zhvillimin normal të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 3. Zëvendëskryetari, në rast mungese ose pengese dhe me autorizim të tij, zëvendëson Kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.” Lidhur me funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, palët nuk e vunë në diskutim pozicionin e tij ligjor si funksionar me kohë të plotë. Në këtë kuptim, siç u theksua edhe më lart, në vlerësimin e zgjidhjeve ligjore konkrete, Gjykata nisat nga prezumimi i pajtueshmërisë së tyre me Kushtetutën.

30. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vendosur disa standarde kushtetuese lidhur me përbërjen dhe funksionimin e KLD-së. Kështu në vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 Gjykata ka vlerësuar se për gjyqtarët që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore

Kombëtare në përbërje të KLD-së, Kushtetuta saktëson jo vetëm numrin, por edhe cilësinë e tyre si gjyqtarë, ashtu siç vepron edhe kur përcakton pjesëmarrjen për shkak të funksionit (*ex officio*) të Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të Ministrit të Drejtësisë, të cilët nuk janë dhe nuk mund të jenë permanentë. Në funksion të mbrojtjes së gjyqësorit, Kushtetuta nuk i ka shkëputur anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga gjykimi dhe, si rrjedhojë, as nga interesat e trupës gjyqësore. Detyra e parë dhe kryesore është qenia gjyqtar në kuptimin që gjyqtarët japin vendime e bëjnë drejtësi në mënyrë të vazhdueshme. Lidhur me këtë detyrë, Kushtetuta ka bërë përjashtim për sa i përket veprimtarisë jo permanente të tyre në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqtarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues” (*shih për më gjerë vendimin nr. 14, 22.5.2006*).

31. Nisur nga përcaktimi ligjor i detyrave të zëvendëskryetarit të KLD-së dhe standardeve të mësipërme kushtetuese Gjykata çmon se funksioni i zëvendëskryetarit të KLD-së nuk mund të ushtrohet njëkohësisht nga një mbajtës i funksionit të ministrit apo gjyqtarit. Gjykata çmon se anëtarët e KLD-së, për shkak funksionit (*ex officio*): kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë dhe 9 gjyqtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, nuk mund të zgjidhen në këtë funksion.

32. Për sa më sipër, Gjykata, bazuar në rregullin e vazhdimësisë së jurisprudencës, e sheh me vend t’u përbahet standardeve të Gjykatës Kushtetuese të shtjelluara më sipër për të gjitha çështjet e analizuar në funksion të këtij gjykimi. Gjykata nuk identifikon asnjë arsye të rëndësishme e cila mund të shërbejë për ndryshimin apo korrigjimin e doktrinës zyrtare kushtetuese. Bazuar në standardet e interpretuara në vendimin e referuar më sipër (*vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 i Gjykatës Kushtetuese*), Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit që parashikimet e nenit 7 të ligjit objekt shqyrtimi bien ndesh me nenin 147/3 të Kushtetutës, është i pabazuar.

33. Gjykata arriti në përfundimin se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe hierarkisë së normave, janë të pabazuara. Për rrjedhojë, kërkesa për shfuqizimin e nenit 7 të ligjit nr. 101, datë



31.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, të ndryshuar”, duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, duke u bazuar në nenet 131, shkronja “a”; 134, paragrafi 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenet 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Sokol Berberi, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Gani Dizdari

MENDIM PAKICE

1. Kërkuesi pretendon se neni 7 i ligjit objekt kërkesë, që parashikon zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së vetëm mes anëtarëve që zgjidhen nga Kuvendi, cenon parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve. Duke pasur të qartë rolin e KLD-së në garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, Kushtetuta i ka lënë mundësi Presidentit të Republikës që të propozojë një kandidat për zëvendëskryetar nga të gjithë anëtarët e KLD-së. Po sipas tij, ky nen kapërcen parashikimet kushtetuese si në formë edhe në përmbajtje dhe si i tillë cenon parimin e hierarkisë së normave. Neni 147, paragrafi 3, i Kushtetutës nuk përmban elementet e një norme referuese, me anë të së cilës t’i delegohen kompetenca ligjvënësit të zakonshëm për të përcaktuar mënyrën e zgjedhjes së zëvendëskryetarit. Mendoj se kjo kërkesë duhet të ishte pranuar, prandaj vlerësoj të shprehem me mendim pakice.

2. Sipas nenit 4/3 të Kushtetutës, *dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe*. Ky është një parim themelor, sipas të cilit kur rregulli kushtetues parashikohet shprehimisht, ai nuk mund të

mënjanohet dhe as të tejkalohet, por duhet të zbatohet drejtpërsëdrejti. Përrjashtimi kushtetues nënkupton se normat kushtetuese mund edhe të mos gjejnë zbatim drejtpërsëdrejti, kur Kushtetuta ka ngarkuar posaçërisht organet shtetërore përkatëse për të nxjerrë ligjet dhe aktet e tjera nënligjore, me qëllim rregullimin e marrëdhënieve në fusha të ndryshme dhe në përputhje me hierarkinë e normave.

3. Në zbrëthim të kësaj dispozite kushtetuese, Gjykata Kushtetuese ka theksuar se Kushtetuta, kur e ka parë të arsyeshme, ka parashikuar shprehimisht zbatimin e drejtpërdrejt të saj ose nuk ka lënë hapësirë rregulluese për ligjvënësin. Si rrjedhim, përmbajtja e dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira, me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë nuk është i nevojshëm zbatimi i drejtpërdrejt i saj. Nëse ndodhemi para kësaj situatë, është e pritshme që aktet normative, që do të dalin për këtë qëllim, të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*vendimet nr. 29/2005 dhe nr. 3/2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas kësaj gjykate, për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*vendimi nr. 212/2002*).

4. Kushtetuta, si ligji themelor i shtetit, detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Uniteti i sistemit normativ qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës “së krijuar”. Në këtë kuptim, Kushtetuta është norma bazë mbi të cilën krijohen dhe bazohen të gjitha normat e tjera, përfshirë edhe ligjet. Neni 147/3 i Kushtetutës parashikon se *KLD-ja, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e saj një zëvendëskryetar*. Kjo dispozitë është e qartë, koncize dhe mjaftueshmërisht vetërregulluese për t’u zbatuar edhe në mungesë të një ligji detajues. Por duke qenë se ndodhemi para rastit kur ligjvënësi ka vlerësuar të nevojshëm rregullimin me ligj, kjo ndërhyrje do të duhej të ishte e tillë që të mos kufizonte rrethin e subjekteve të propozuara nga Presidenti si kandidatë për zëvendëskryetar të KLD-së, në mungesë të autorizimit të shprehur kushtetues për këtë veprim.

5. Në këtë këndvështrim, në rastin konkret, ndryshimi që ka sjellë neni 7 i ligjit objekt kërkesë,



sipas të cilit Presidenti për zgjedhjen e zëvendëskryetarit të KLD-së duhet të kufizohet mes anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, pra tek 3 anëtarë, ndryshon modelin kushtetues të përzgjedhjes. Mendoj se ky rregullim ligjor nuk është në pajtim me vullnetin e kushtetutëbërësit, i cili nuk ka parashikuar asnjë kufizim për këtë rast, prandaj dhe Presidenti nuk do të duhej të kufizohej në përzgjedhjen e zëvendëskryetarit.

Kryetar: Bashkim Dedja

MENDIM PAKICE

1. Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës së Presidentit të Republikës së Shqipërisë me objekt kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 7 të ligjit nr. 101, datë 31.7.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8811, datë 17.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë””, të ndryshuar.

2. Kërkuesi pretendon se ndryshimi që sjell neni 7 i ligjit të kundërshtuar, për propozimin e zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD) vetëm nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi, cenon parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, si dhe parimin e hierarkisë së normave.

3. Shumica, për parimin e ndarjes dhe të balancimit të pushteteve, ka arsyetuar se ndryshimet ligjore të kundërshtuara nuk kanë ndryshuar formulën e përbërjes së KLD-së, pra përfaqësimi i gjyqësorit në këtë organ plural mbetet i pacenuar si në drejtim të numrit, ashtu edhe lidhjes së tyre të drejtpërdrejtë me trupën gjyqësore (në cilësinë e gjyqtarit). ... Shumica, nisur nga fakti se zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ushtron më së shumti detyra që i përkasin sferës administrative dhe në këtë kuptim nuk gëzon pozitë dominuese në veprimtarinë e KLD-së, që lidhet me çështjen e administrimit të gjyqësorit, ka arritur në përfundimin se zgjedhja e zëvendëskryetarit të KLD-së nga anëtarët e zgjedhur nga parlamenti nuk paraqet elemente të cenimit të parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve (*shih paragrafët 18-21 të vendimit*).

4. Ndërsa për cenimin e parimit të hierarkisë së normave shumica, nga njëra anë, konstaton se në pamje të parë neni i kundërshtuar të krijon idenë e një ndryshimi në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të

KLD-së, duke e ngushtuar këtë zgjedhje vetëm tek 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi (*shih paragrafin nr. 27 të vendimit*). Por, nga ana tjetër, pavarësisht këtij konstatimi, shumica, bazuar në vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të kësaj Gjykate, ku theksohet se për gjyqtarët që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në përbërje të KLD-së, Kushtetuta saktëson jo vetëm numrin, por edhe cilësinë e tyre si gjyqtarë dhe se veprimtaria e tyre në KLD është jo permanente (*shih paragrafin nr. 30 të vendimit*), ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuesit që parashikimet e nenit 7 të ligjit objekt shqyrtimi bien ndesh me nenin 147/3 të Kushtetutës, është i pabazuar (*shih paragrafin nr. 32 të vendimit*).

5. Shumica arsyeton se detyra e zëvendëskryetarit nuk mund të ushtrohet njëkohësisht nga një mbajtës i funksionit të ministrit (!) apo gjyqtarit. Sipas shumicës anëtarët e KLD-së për shkak funksioni (*ex officio*): Kryetari i Gjykatës së Lartë, Ministri i Drejtësisë dhe 9 gjyqtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare nuk mund të zgjidhen si zëvendëskryetar të KLD-së (*shih paragrafin nr. 31 të vendimit*).

6. Argumentet e shumicës për t'i rrëzuar pretendimet e kërkuesit, që lidhen me cenimin e neneve 4, 7 dhe 116 të Kushtetutës, me arsyet e mësipërme, bien ndesh me parimet dhe përcaktimet kushtetuese. Në ndryshim nga shumica, ne gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se në rastin konkret pretendimet e kërkuesit nuk mund të trajtohen të ndara, por në unitet me njëra – tjetrën. Konkretisht:

7. Neni 147/3 i Kushtetutës sanksionon se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kryeson mbledhjet e tij në mungesë të Presidentit të Republikës”. Ndërsa dispozita ligjore objekt shqyrtimi përcakton se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar”. Sikurse konstaton edhe shumica, dispozita në fjalë, në raport me Kushtetutën, sjell një ndryshim thelbësor, në gjykimin tonë të paautorizuar nga kjo e fundit (Kushtetuta), në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, duke e kufizuar këtë zgjedhje vetëm te tre anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi.



8. Gjykata në jurisprudencën e saj, duke iu referuar nenit 7 të Kushtetutës, që parashikon parimin e ndarjes së pushteteve, ka theksuar se ky parim në demokraci, si formë e qeverisjes, synon kryesisht të mënjanojë rrezikun e përqendrimit të pushtetit në duart e një organi apo të personave të caktuar, gjë që praktikisht mbart me vete rrezikun e shpërdorimit të tij. Për këtë qëllim, pavarësisht se pushteti shtetëror në tërësi është një dhe i pandarë, brenda tij ka një sërë ndërthurjesh dhe raportesh të ndërsjella që Kushtetuta krijon ndërmjet segmenteve të caktuara të tij. Pra, në thelb, në bazë të këtij parimi, tri pushtetet qendrore duhet të ushtrohen jo vetëm në mënyrë të pavarur, por edhe në mënyrë të balancuar. Kjo gjë arrihet nëpërmjet zgjidhjeve kushtetuese që garantojnë kontroll të ndërsjellë dhe ekuilibër të mjaftueshëm midis pushteteve, pa cenuar dhe pa ndërhyrë në kompetencat e njëri-tjetrit (*shih vendimet nr. 24, datë 10.11.2006 dhe nr. 19, datë 03.05.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Parimi i ndarjes së pushteteve nuk duhet kuptuar që çdo pushtet është i mbyllur dhe i pakontrolluar nga askush. Ndarja e pushteteve midis tri degëve të qeverisjes garantohe vetëm nëpërmjet sistemit të kontrolleve dhe ekuilibrave. Në këtë mënyrë, sipas Kushtetutës, aq sa flitet për ndarje, bëhet fjalë edhe për ekuilibër të pushteteve. Qëllimi i një koncepti të tillë kushtetues siguron që të parandalojë çdo degë të qeverisjes për të ushtruar një pushtet të pakufizuar. Kontrollat dhe ekuilibrat që njeh Kushtetuta i japin secilës degë pushtete që kompensojnë apo zbusin ato të degëve të tjera (*shih vendimin nr. 11, datë 27.5.2004 të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse renditen njëri pas tjetrit, tri pushtetet e përmendura nuk qëndrojnë në varësi hierarkike nga njëri-tjetri dhe as nuk dominojnë apo u nënshtrohen ndikimeve reciproke *extra ligjore* (*shih vendimin nr. 11, datë 6.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata lidhur me këtë parim është shprehur se ai shtrihet jo vetëm ndaj tri degëve të pushtetit: ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, por edhe ndaj organeve të tjera kushtetuese të pavarura, kompetencat e të cilave janë të parashikuara nga dispozitat e Kushtetutës. Sipas këtij parimi, asnjë organ, në përbërje ose jo të një prej tre pushteteve, nuk mund të ndërhyjë në

trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve që, sipas rastit, do të përbënin objektin qendror të veprimtarisë së organeve apo institucioneve të tjera kushtetuese (*shih vendimin nr. 15, datë 15.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Gjykata, gjithashtu, ka theksuar se normat kushtetuese nuk mund të interpretohen si norma të izoluar, por duhen parë në harmoni me normat e tjera kushtetuese. Një qëndrim i tillë bazohet në faktin se asnjë dispozitë e Kushtetutës nuk mund të nxirret jashtë kontekstit të saj dhe të interpretohet më vete, pasi çdo dispozitë kushtetuese duhet të interpretohet në mënyrë që të jetë e pajtueshme me parimet themelore kushtetuese, kjo për arsye se të gjitha normat dhe parimet kushtetuese formojnë një sistem harmonik, pa kontradikta të brendshme (*shih vendimin nr. 25, datë 24.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Nisur nga kjo premisë, mendojmë se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve duhen të shqyrtohen në përputhje me parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës, që përcakton: *"E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetua parashikon ndryshe"*, si dhe parimin e hierarkisë së burimeve të së drejtës të përcaktuar në nenin 116 të Kushtetutës.

13. Në këtë drejtim, Gjykata në jurisprudencën e saj tashmë të konsoliduar është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*shih vendimet nr. 5, datë 05.02.2014 dhe nr. 23, datë 8.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Piramida e akteve normative, e sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës,



përcakton marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik nuk është një radhitje e barasvlershme normash, por një sistem hierarkik, i cili përbëhet nga nivele të ndryshme vlefshmërie dhe në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash, duke përfshirë kështu edhe fuqinë e caktuar juridike. Kjo piramidë aktesh normative ka në majë të saj Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shih vendimet nr. 5, datë 5.2.2014 dhe nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Kushtetuta, si akt themelor i një shteti, parashikon organet dhe kushtet në të cilat duhet të nxirren aktet normative, duke synuar qëndrueshmërinë e tyre. Kushtetuta, mbi bazën e të cilës miratohen të gjitha aktet e tjera normative, mund të ndërmerret si mision të saj edhe përcaktimin e përmbajtjes së ligjeve që duhet të miratohen në të ardhmen nga ligjvënësi. Kështu, konsiderohet si karakteristikë e kushtetutave të shkruara përcaktimi konkret i disa parimeve kryesore ose përjashtimi absolut i disa rrethanave që konsiderohen si të papranueshme për të (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata është shprehur gjithashtu se rregullimet që bën Kushtetuta nuk mund të jenë gjithmonë të plota ose shteruese. Megjithatë disa çështje lidhur me rendin shtetëror mund të parashikohen në mënyrë të hollësishme prej saj, gjithsesi mbeten mjaft aspekte të organizimit të jetës institucionale për t'u parashikuar nga ligje ose akte të tjera normative, sipas rastit. Pra, Kushtetuta nuk ka për qëllim të rregullojë hollësisht çdo çështje të organizimit të jetës shoqërore politike të një vendi, por vetëm të parimeve dhe kritereve bazë mbi të cilat duhet të mbështetet ajo. Shpesh, Kushtetuta qëllimisht lë hapësira rregullimi nga ligjvënësi i zakonshëm, në mënyrë që të mos pengojë marrjen e nismave politike, ekonomike, sociale e kulturore nga partitë politike ose qeveria. Por, Kushtetuta, përveç kësaj mund të parashikojë hollësisht dhe shprehimisht rastet për të cilat nuk mund t'i lërë hapësira rregullimi ligjvënësit të zakonshëm (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Bazuar në këto parime, Gjykata ka theksuar se për çdo rast, kur rregullimi kushtetues parashikohet shprehimisht prej saj, ai detyrimisht do të zbatohet drejtpërdrejt. Përmbajtja e

dispozitës kushtetuese nuk mund të mënjanohet ose të tejkalohet duke u dhënë përparësi akteve juridike që dalin në bazë dhe për zbatim të Kushtetutës. Ky detyrim rrjedh nga përmbajtja e nenit 4/3 të Kushtetutës. Në rastet kur Kushtetuta lë hapësira me qëllim delegimin e kompetencës ligjvënësit të zakonshëm, atëherë, nuk është i nevojshëm referimi te kjo dispozitë, pra e zbatimit të drejtpërdrejt të saj. Nëse ndodhemi para kësaj situatë, është e pritshme që aktet normative që do të dalin për këtë qëllim të respektojnë hierarkinë e akteve normative (*shih vendimin nr. 3, datë 20.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këto kushte përpara Gjykatës shtrohej për diskutim çështja nëse rregullimi që kushtetutëbërësi ka bërë nëpërmjet nenit 147/3 të Kushtetutës i lë hapësira delegimi ligjvënësit, pra nëse rregullimi i dispozitës në fjalë është shterues ose jo.

19. Në rastin objekt shqyrtimi, mendojmë se Kushtetuta nuk ka pasur për qëllim të autorizojë ligjvënësin të përcaktojë rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për zëvendëskryetar të KLD-së, pasi këtë ajo e ka bërë shprehimisht nëpërmjet nenit 147/3 të saj. Dispozita është e qartë në formulimin e saj, ajo nuk lë vend për hapësira të tjera ndërhyrjeje dhe nuk bën asnjë lloj autorizimi për ligjvënësin. Kushtetuta në mënyrë të shprehur i ka atribuuar Presidentit kompetencën që të propozojë nga radhët e anëtarëve të KLD-së një zëvendëskryetar, pa bërë asnjë kufizim apo përcaktim për një rreth të caktuar prej tyre. Rrjedhimisht, bazuar në nenin 4/3 të Kushtetutës, të lartpërmendur, dispozita në fjalë gjen zbatim drejtpërsëdrejti.

19. Në ndryshim nga shumica mendojmë se fakti që detyra e zëvendëskryetarit duhet të ushtrohet me kohë të plotë, nuk e përllig nga pikëpamja kushtetuese zgjedhjen e bërë nga ligjvënësi. Shumica, për të justifikuar këtë zgjedhje, në mënyrë artificiale dhe jashtë kontekstit të çështjes në shqyrtim, në argumentet e saj përpiqet të vendosë shenjë barazimi midis anëtarëve të KLD-së, *ex officio* (ministrit të Drejtësisë dhe kryetarit të Gjykatës së Lartë) dhe 9 gjyqtarëve të të gjitha niveleve (?!). Përveç sa më sipër (*shih paragrafin nr. 18*), përpara kësaj Gjykate shtrohej për zgjedhje edhe çështja nëse Kuvendi me “kufizimin” e vendosur në nenin 7 të ligjit objekt shqyrtimi, pra zgjedhja e zëvendëskryetarit vetëm nga 3



përfaqësuesit e Kuvendit, deformon vullnetin e kushtetutëbërësit dhe për rrjedhojë kufizon të drejtën e Presidentit që në respekt të këtij vullneti të mund të propozojë për këtë detyrë edhe përfaqësues të ardhur në KLD nga radhët e gjyqësorit.

20. Qëllimi (*ratio legis*) i ligjit objekt shqyrtimi mbështetet në faktin që nëse Presidenti i Republikës do të propozonte një prej 9 gjyqtarëve të zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare si zëvendëskryetar, do të prishej formula e përbërjes së KLD-së, pasi gjyqtari nuk mund të ushtrojë dy funksione njëherësh. Mendojmë se edhe ky argument është i sforcuar dhe nuk ka mbështetje juridike kushtetuese. Pikërisht kjo është një çështje që mund të zgjidhet me ligj nga Kuvendi. Sjellim këtu në vëmendje se ligji nr. 8811, datë 17.05.2001, në formulimin e tij përpara ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 101, datë 31.7.2014, në nenin 12/3 parashikonte se: “*në rastin kur është zgjedhur nga radhët e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që janë gjyqtarë, Zëvendëskryetari, për kohën që shërben në këtë detyrë, nuk e ushtron funksionin e gjyqtarit*”¹.

21. Gjithashtu vlerësojmë se edhe pretendimi i subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, se praktika e deritanishme ka treguar se të gjithë presidentët në detyrë në kohë të ndryshme e kanë ushtruar këtë kompetencë duke propozuar si zëvendëskryetar të KLD-së, një nga anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi, nuk është i bazuar. Edhe pse praktika mund të ketë rëndësinë e saj, bazuar në parimet e mishëruara në jurisprudencën kushtetuese ajo mund të shërbejë në ndërmarrjen e nismave për ndryshimin e Kushtetutës, por në asnjë rast ky ndryshim nuk mund të bëhet me një akt ligjor që kapërcen frymën dhe përmbajtjen e saj.

22. Edhe referimi i shumicës në vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, mendojmë se është i gabuar, pasi në atë vendim Gjykata kontrollin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të ligjit nr. nr. 9448, datë 5.12.2005 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8811, datë 17.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” nuk e ka trajtuar në lidhje me nenin

147/3 të Kushtetutës, por me disa parime të tjera të tilla, si papajtueshmëria e detyrës së gjyqtarit me mandatin e anëtarit të KLD-së apo ekzistenca e konfliktit të interesave midis këtyre detyrave. Në këtë këndvështrim me të drejtë Gjykata ka vlerësuar se Kushtetuta e ka bërë vetë specifikimin, duke i quajtur gjyqtarë anëtarët e KLD-së që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare.

23. Duke konsideruar sa më sipër, mendojmë se kufizimi i vendosur nga ligjvënësi në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, është bërë në mungesë të një autorizimi kushtetues si dhe passjell një ndryshim në modelin kushtetues përzgjedhës (neni 147/3 i Kushtetutës). Çka bie ndesh me parimin se “*uniteti i sistemit normativ qëndron në varësinë që ekziston ndërmjet normës “krijuese” dhe normës “së krijuar”*” (shih vendimin nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese) në të cilin “*Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë*” (neni 4/2 i Kushtetutës).

24. Për më tepër, shumica në vendimmarrjen e saj nuk ka respektuar jurisprudencën e kësaj Gjykate dhe konkretisht parimin se “*për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla (...) atje ku nuk është shprehur*” (shih vendimet nr. 25, datë 15.12.2008; nr. 29, datë 9.11.2005 dhe nr. 212, datë 29.12.2002 të Gjykatës Kushtetuese). Në vlerësimin tonë, dispozita ligjore e kundërshtuar nuk mbështetet në parimet dhe rregullimet e specifikuar kushtetuese, por e tejkalon Kushtetutën si në formë, ashtu edhe në përmbajtje. Ky tejkallim cenon edhe parimin e shtetit të së drejtës, të shprehur me hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës, në raport me normat e tjera ligjore.

25. Për këto arsye mendojmë se neni 7 i ligjit të kundërshtuar është i papajtueshëm me nenet 4, 7 dhe 147/3 të Kushtetutës, prandaj ai duhej të shfuqizohej.

Anëtarë: Gani Dizdari, Vladimir Kristo

¹ Ky nen i është nënshtuar kontrollit kushtetues me vendimin nr. 14, datë 22.05.2006 të Gjykatës, e cila nuk ka gjetur elemente të antikushtetutshmërisë së tij.



MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Presidenti i Republikës për kontrollin e kushtetutshmërisë së nenit 7 të ligjit nr. 101/2014, vlerësoj të paraqes argumentet për qëndrimin tim në pakicë.

2. Në nenin 147/3 të Kushtetutës parashikohet: “3. Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e tij një zëvendëskryetar. Zëvendëskryetari organizon veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si dhe kryeson mbledhjet e tij në mungesë të Presidentit të Republikës”, ndërsa në dispozitën ligjore objekt shqyrtimi, parashikohet se “Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me propozim të Presidentit, zgjedh nga radhët e anëtarëve të zgjedhur nga Kuvendi një Zëvendëskryetar”.

3. Një shtet i së drejtës orientohet drejt hierarkisë së normave juridike, prandaj hierarkia, statusi dhe efekti i normave ligjore janë të parashikuara në Kushtetutë. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor. Për rrjedhojë, në rastet e konflikteve ndërmjet normave me fuqi të ndryshme juridike, norma me fuqi më të lartë ka epërsi në raport me normën tjetër (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese*). Në doktrinën dhe jurisprudencën kushtetuese, parimi i shtetit të së drejtës është parë i lidhur si me parimin e epërsisë së Kushtetutës, ashtu edhe me parimin e integritetit të saj. Gjykata ka theksuar se përderisa Kushtetuta ka trajtuar organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe statusin e drejtuesve të tyre, ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kufijtë e të drejtave të tyre. Për funksionet kushtetuese të organeve, atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji (*shih vendimin nr. 212, datë 29.10.2002 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Sipas shumicës, dispozita ligjore objekt kundërshtimi, në raport me Kushtetutën, të krijon idenë e një ndryshimi në rrethin e subjekteve që mund të propozohen nga Presidenti i Republikës si kandidatë për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së, duke e ngushtuar këtë zgjedhje vetëm tek 3 anëtarët e zgjedhur nga Kuvendi (*shih prg. 26*).

5. Në kundërshtim me këtë qëndrim vlerësoj se kjo dispozitë jo thjesht krijon idenë, por ajo në përmbajtjen e saj sjell kufizim në rrethin e këtyre subjekteve.

6. Neni 147/1 i Kushtetutës, i cili rregullon mënyrën e funksionimit dhe përbërjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përcakton qartë se ky Këshill përbëhet, në shumicën e tij, nga gjyqtarë që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi, si edhe nga disa anëtarë të tjerë, të cilët nuk janë të zgjedhur, por që e ushtrojnë këtë funksion *ex officio*, për shkak të një funksioni tjetër publik.

7. Në bazë të nenit 13 të ligjit nr. 8811, datë 17.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, zëvendëskryetari i KLD-së është funksionar me kohë të plotë dhe ai ushtron këto detyra: kujdeset për veprimtarinë normale të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; organizon dhe drejton veprimtarinë e Inspektoratit dhe të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë; ndjek veprimet e Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për verifikimin e ankesave dhe të të dhënave për gjyqtarët dhe për zbatimin e detyrave të ngarkuara nga Këshilli, në rastet e procedimeve disiplinore të filluara nga Ministri i Drejtësisë; ç) organizon punën përgatitore për rendin e ditës dhe për zhvillimin normal të mbledhjes së Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Zëvendëskryetari, në rast mungese ose pengese dhe me autorizim të tij, zëvendëson Kryetarin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në ushtrimin e funksioneve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 11 të këtij ligji.

8. Nisur nga përcaktimi ligjor i detyrave të zëvendëskryetarit të KLD-së, bashkohem me qëndrimin e shumicës se ky funksion nuk mund të ushtrohet njëkohësisht nga ata persona që e ushtrojnë këtë detyrë *ex officio*, dhe që janë Ministri i Drejtësisë si dhe Kryetari i Gjykatës së Lartë. Por ky qëndrim nuk është i vlefshëm për anëtarët e zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare dhe që ushtrojnë funksionin e gjyqtarit.

9. Gjykata ka vlerësuar se sipas nenit 143 të Kushtetutës “qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”. Nga përmbajtja e kësaj norme del që detyra e parë dhe kryesore është qenia gjyqtar, në kuptimin që gjyqtarët japin vendime e bëjnë drejtësi në mënyrë të vazhdueshme. Për gjyqtarët që zgjidhen nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare në përbërje të KLD-së, Kushtetuta saktëson jo vetëm numrin por edhe cilësinë e tyre si anëtarë që qëndrojnë në detyrë për një periudhë 5-vjeçare (gjë që



parashikohet edhe në nenin 6/1 të ligjit nr. 8811/2001), ashtu siç vepron edhe kur përcakton pjesëmarrjen për shkak të funksionit (*ex officio*) të Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Gjykatës së Lartë dhe të Ministrit të Drejtësisë, të cilët nuk janë permanentë dhe për të cilët nuk shprehet për qëndrim në detyrë.

10. Në funksion të mbrojtjes së gjyqësorit, Kushtetuta nuk i ka shkëputur anëtarët gjyqarë të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nga gjykimi dhe, si rrjedhojë, as nga interesat e trupës gjyqësore. Lidhur me këtë detyrë, Kushtetuta ka bërë përfundim për sa i përket veprimtarisë jo permanente të tyre në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, në të cilin ata përfaqësojnë trupën e gjyqarëve që i ka zgjedhur në këtë organ kushtetues (*shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Përjashtimet nga rregullimi kushtetues nuk mund të vendosen me ligj. Vetë kushtetutëbërësi, kur e ka gjykuar të arsyeshme, ka bërë përfundim në mënyrë të posaçme. Kështu, ai ka lejuar shprehimisht edhe anëtarësinë e Presidentit të Republikës ose të Ministrit të Drejtësisë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, megjithëse nenet 89 e 103/2 të Kushtetutës kanë përcaktuar përkatësisht se ai (Presidenti i Republikës) “nuk mund të mbajë asnjë detyrë tjetër publike” ose “Ministri i Drejtësisë nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore” (*shih vendimin nr. 14, datë 22.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Parashikimi në nenin 147/1 të Kushtetutës për qëndrimin në detyrë të gjyqarëve të zgjedhur si anëtarë të KLD-së për një periudhë 5-vjeçare, përbën një përjashtim të rregullit që parashikohet në nenin 143 të Kushtetutës. Është i vetmi rast kur gjyqarët mund të ushtrojnë edhe një detyrë tjetër publike që është ajo e anëtarit të KLD-së dhe që nuk bie ndesh me funksionin e tyre të gjyqarit.

13. Në kuptim të nenit 143 të Kushtetutës mes detyrës së gjyqarit dhe të anëtarit të KLD-së nuk ka papajtueshmëri dhe e njëjta logjikë vlen edhe për funksionin e zëvendëskryetarit të KLD-së. Për pasojë, analogjia e përdorur nga shumica mes funksionarëve të zgjedhur dhe atyre *ex officio* nuk është e përshtatshme në çështjen në fjalë.

14. Po ashtu referimi në praktikën e deritanishme vlerësoj se nuk është relevant për çështjen në fjalë. Sigurisht që organet zbatuese të Kushtetutës dhe ligjit janë edhe interpretuesit e

parë të këtyre normave dhe në këtë kuptim kjo situatë nuk është pasojë e interpretimit të nenit 147/3 të Kushtetutës në një frymë të ndryshme nga sa ka qenë qëllimi i ligjvënësit, por për shkak të faktit se në praktikë kanë qenë shumë të rralla rastet kur një gjyqtar i zgjedhur nga Konferenca Gjyqësore si anëtar i KLD-së të ketë shprehur dëshirën dhe, për pasojë, edhe të jetë propozuar për të ushtruar detyrën e zëvendëskryetarit të KLD-së.

15. Sa më sipër ka qenë edhe fryma e kushtetutëbërësit në parashikimin e nenit 147/3 të Kushtetutës. Në rastin konkret dispozita ligjore e kundërshtuar ka dalë tej këtij parashikimi kushtetues dhe në mungesë të një delegimi të shprehur, ndërkohë që zbatimi i kësaj norme kushtetuese është një çështje që duhej t'i lihej interpretimit dhe zbatimit konkret, rast pas rasti, të institucioneve të përfshira në proces.

Anëtarë: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 17, datë 10.4.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“ “
Vitore Tusha	anëtare e	“ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“ “
Gani Dizdari	anëtar i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar i	“ “
Fatos Lulo	anëtar i	“ “
Sokol Berberi	anëtar i	“ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 27.1.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 56/24 Akti, që i përket:

KËRKUES: Shpresa Kekezi, Teri Kekezi, Bledar Lasku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-55, datë 22.01.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.



GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Sokol Berberi; mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës; prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës dhe, diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarit janë trashëgimtarë të K.L., ish-pronar i një trualli të ndodhur në Tiranë, në rrugën “Muhamet Gjollështa”, të njohur me vendimin nr. 499, datë 21.3.1996 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP), Tiranë. Me vendimet nr. 562, datë 20.5.1996; nr. 705, datë 30.9.1996 dhe nr. 170, datë 30.9.1997 të KKKP-së Tiranë, është vendosur kompensimi fizik i trashëgimtarëve, duke i kompensuar me një sipërfaqe prej 1070 m².

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) në datën 05.10.2007 ka inspektuar zyrën rajonale të KKKP-së Tiranë dhe ka konstatuar se vendimet e sipërpërmendura të KKKP-së janë marrë në kundërshtim me ligjin. Për pasojë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (AKKP), pas përfundimit të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 480, datë 27.11.2007, ka vendosur: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimeve nr. 562, datë 20.5.1996; nr. 705, datë 30.9.1996 dhe nr. 170, datë 30.09.1997 të KKKP-së Tiranë; kthimin e palëve në gjendjen e mëparshme dhe rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura”.

3. Kërkuarit kanë ngritur padi kundër vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr. 7086, datë 25.7.2008, ka vendosur, ndër të tjera, pranimin e padisë dhe shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 480, datë 27.11.2007 të AKKP-së.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 241, datë 15.2.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 7086, datë 25.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2012-1554, datë 28.06.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit të

paraqitur nga kërkuarit.

6. Ky vendim është bërë objekt shqyrtimi në Gjykatën Kushtetuese (Gjykata), e cila, me vendimin nr. 26, datë 24.6.2013, pasi ka konstatuar cenim të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, e ka shfuqizuar duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

7. Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-55, datë 22.1.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuarit, duke arsyetuar se nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjë prej rasteve të cituara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

II

8. **Kërkuarit** i janë drejtuar Gjykatës duke pretenduar se ndaj tyre është zhvilluar një proces i parregullt ligjor. Sipas kërkuarëve është cenuar:

8.1 Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese. Gjykata e Lartë vetëm ka shtuar formalisht shkaqet e rekursit në vendim pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, konkretisht pretendimit në lidhje me kompetencën rishikuese të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, të shpallur si antikushtetuese nga Gjykata, dhe pretendimit për fuqinë juridike të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 528, datë 13.5.1996.

8.2 Siguria juridike që nga momenti i rishikimit të vendimeve të KKKP-së nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, kompetencë e cila është shpallur si antikushtetuese, dhe kjo ka sjellë si pasojë cenimin e të drejtës së pronës. Gjykimet e zhvilluara në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe Gjykatën e Lartë kanë lejuar shkeljen e këtyre të drejtave kushtetuese.

9. **Subjekti i interesuar** AKKP-ja, ka prapësuar si vijon:

9.1. Nga pikëpamja e së drejtës procedurale, rishikimi i vendimeve të AKKP-së ka qenë në juridiksionin administrativ dhe kompetencat ligjore të AKKP-së. Procedurat e ndjekura nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP rezultojnë të kenë respektuar të gjitha të drejtat kushtetuese dhe ligjore të kërkuarëve.



9.2. Vendimet e kthimit dhe të kompensimit të pronës, objekt i shqyrtimit në themel të çështjes, janë miratuar nga KKKP-ja në kundërshtim me ligjin dhe aktet nënligjore të kohës;

9.3. Kërkesve nuk u është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si rezultat i shfuqizimit të vendimeve të KKKP-së nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

10. Kërkesit kanë pretenduar se është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim pretendimet e ngritura në rekurs, megjithëse ato kishin të bënin me shkelje kushtetuese. Gjykata e Lartë vetëm ka shtuar formalisht shkaqet e rekursit në vendim pa u dhënë përgjigje pretendimeve me natyrë kushtetuese, konkretisht pretendimit në lidhje me kompetencën rishikuese të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, të shpallur si antikushtetuese nga Gjykata, dhe pretendimit për fuqinë juridike të VKM-së nr. 528, datë 13.5.1996. Rekursi përmban shkaqe që lidhen me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të caktuara juridike dhe Gjykata e Lartë duhej të shpjegonte pse këto shkaqe nuk janë parashikuar në nenin 472 të KPC-së.

11. Gjykata rithekson se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 55, datë 18.12.2012; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 8, datë 16.3.2011 dhe nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata, kërkesën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, e ka vlerësuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre (*shih*

vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

13. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, arsytimi i kufizuar i vendimit të marrë në dhomën e këshillimit nuk e cenon procesin e rregullt ligjor. Kjo formë arsytimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit, nga ana e kolegjeve të saj, gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Sikundër për pranimin, ashtu edhe për mospranimin e rekursit, dhoma e këshillimit luan rolin e një filtri të kërkesave që i drejtohen Gjykatës së Lartë. Veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, kur kërkesat e ligjit për kalimin në seancë nuk janë plotësuar, vendoset për mospranimin e kërkesës dhe ky lloj shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe nuk mund të bëhet pjesë e kontrollit kushtetues që zhvillon Gjykata (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 108, datë 3.10.2012 dhe nr. 17, datë 17.5.2011 të Gjykatës Kushtetuese si dhe vendimin nr. 143, datë 7.12.2011 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*).

14. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar se “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsytim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë” (...) “arsytimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsytim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishgjoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

15. Në rastin konkret, vendimi nr. 00-2012-1554, datë 28.6.2012 i Gjykatës së Lartë është shfuqizuar nga Gjykata me vendimin nr. 26, datë



24.06.2013, pasi është konstatuar cenim i procesit të rregullt ligjor në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Duke e rikthyer çështjen në Gjykatën e Lartë, Gjykata i dha mundësinë kësaj të fundit të bënte të mundur realizimin e një procesi të rregullt ligjor. Vendimi nr. 00-2014-55, datë 22.1.2014 i Gjykatës së Lartë është vlerësuar nga Gjykata kundrejt respektimit të standardeve të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të marrë në dhomë këshillimi, që ka përcaktuar vetë jurisprudenca kushtetuese. Nisur nga ky vlerësim, Gjykata konkludon se në rastin konkret Gjykata e Lartë, pas rigjykimi të çështjes, e ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit të saj objekt shqyrtimi.

Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuësve, në lidhje me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, është i pabazuar.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të sigurisë juridike

17. Kërkuësit kanë pretenduar, gjithashtu, se është cenuar siguria juridike që në momentin e rishikimit të vendimeve të KKKP-së nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, kompetencë e cila është shpallur si antikushtetuese nga Gjykata. Për pasojë, ky cenim i procesit të rregullt ligjor, i lejuar nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, ka sjellë edhe cenimin e të drejtës së pronës.

18. Gjykata ka theksuar se siguria juridike është ndër elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin të sistemi juridik (*shih vendimet nr. 25, datë 28.4.2014 dhe nr. 20, datë 11.07.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursat për pretendime të shkeljes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe

i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 32, datë 28.12.2009 dhe nr. 4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Një nga detyrimet që kanë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është edhe zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehin qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është detyrim kushtetues; ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj (*shih vendimet nr. 21, datë 29.4.2010; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 5, datë 7.2.2001 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Me vendimin nr. 27, datë 26.5.2010 (nr. 27/2010) Gjykata, e investuar nga Gjykata e Lartë dhe Avokati i Popullit, ka shpallur si të papajtueshme me Kushtetutën kompetencën e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shqyrtuar kryesisht vendimet e dhëna nga KKKP-ja. Ajo është shprehur në këtë vendim se “kompetenca e drejtorit të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të ish- KKKP-së, të cilat nuk janë ankimuar brenda afateve ligjore dhe si të tilla kanë marrë formë të prerë, përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi zbatimi nga një organ administrativ si AKKP-ja i parimeve të



revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-së, që nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ, konsiderohet si ndërhyrje e pajustificuar mbi të drejtat civile të shtetasve”.

22. Vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës është shpallur në datën 26.5.2010 dhe ka hyrë në fuqi në datën 5.7.2010, që është dhe data e botimit të vendimit në Fletoren Zyrtare nr. 81. Në rastin konkret, vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është shpallur në datën 15.2.2010, pra përpara se vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës të hynte në fuqi.

23. Neni 76/b i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” rregullon efektet juridike të vendimeve, duke sanksionuar se vendimet e kësaj Gjykate që kanë shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtuësëm me Kushtetutën ose me marrëveshjet ndërkombëtare, si rregull, sjellin efekte juridike nga data e hyrjes së tyre në fuqi. Si rregull përjashtimor, vendimi ka fuqi prapavepruese, ndër të tjera, ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë.

24. Në përputhje me parashikimet e nenit 449 dhe 451 të KPC-së, vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar, në bazë të nenit 479 të KPC-së (*shih vendimet nr. 16, datë 21.3.2014 dhe nr. 56, datë 21.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata e Apelit Tiranë e ka shpallur vendimin e saj përpara se të hynte në fuqi vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës, i cili shfuqizoi dispozitën ligjore që lejonte kompetencën e drejtorit të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të ish-KKKP-së. Duke qenë se kjo kompetencë e drejtorit të AKKP-së nuk ishte deklaruar antikushtetuese në kohën e gjykimit në apel dhe në datën e shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit, kjo e fundit ka zbatuar ligjin e kohës që ka qenë në fuqi. Në këto kushte, bazuar në arsyetimin e mësipërm, Gjykata çmon se nuk ndodhet përpara cenimit të sigurisë juridike, në kuadër të procesit rregullt ligjor. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuësve në këtë drejtim është i pabazuar.

25. Si përfundim, nisur nga jurisprudenca kushtetuese dhe konkluzionet e arritura më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësve për cenim të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të

nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pambështetura.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Sokol Berberi

MENDIM PARALEL

1. Në çështjen me kërkuese Shpresa Kekezi etj., ndonëse ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën për rrëzimin e kërkesës, nuk pajtohem me linjën e arsyetimit të bërë prej saj.

2. Siç rezulton edhe nga rrethanat e kësaj çështjeje, kërkuësit i janë drejtuar edhe më parë kësaj Gjykate, e cila, me vendimin nr. 26, datë 24.6.2013, pasi ka konstatuar cenim të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka shfuqizuar vendimin e Gjykatës së Lartë duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në po atë gjykatë.

3. Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi, me vendimin nr. 00-2014-55, datë 22.1.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuësit. Për pasojë, ata i janë drejtuar sërish Gjykatës Kushtetuese, duke parashtruar para saj të njëjtat pretendime, konkretisht cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për mosmarrjen në shqyrtim të shkaqeve të rekursit, si dhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, për mosmarrjen parasysh të vendimit të Gjykatës Kushtetuese që ka shfuqizuar dispozitën ligjore që i jepte të drejtë Drejtorit të Përgjithshëm AKKP-së të rishikonte vendimet e KKKP-ve.



4. Në vendimin nr. 26, datë 24.6.2013 kam mbajtur qëndrim paralel me shumicën, për arsye se edhe pse isha dakord me shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, nuk isha dakord me linjën e mbajtur në atë vendim, pasi shumica e mbështeti arsyetimin e saj vetëm në faktin se në pjesën hyrëse të vendimit nuk ishin pasqyruar shkaqet e rekursit, çka në vlerësimin tim përbën një qëndrim formal, i cili edhe pse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga kolegjet e Gjykatës së Lartë, nuk u shërben aspak kërkesve për të rivendosur të drejtat e tyre të pretenduara të cenuara. Edhe pse kërkesit pretendonin cenimin e parimit të sigurisë juridike, për të njëjtat shkaqe si në këtë gjykim, Gjykata Kushtetuese nuk u shpreh në lidhje me këtë pretendim.

5. Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005 dhe nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo, sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 19, datë 2.4.2012; nr. 36, datë 25.7.2013 dhe nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në këtë kuptim, Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të kërkesave që lidhen veçanërisht me procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë në dhomën e këshillimit, duhet t'u japë përgjigje pretendimeve të ngritura para saj nga palët në mënyrë që të arrijë në përfundimin nëse pretendimet janë të natyrës ligjore apo kushtetuese dhe, për pasojë, nëse procesi i zhvilluar në Gjykatën e Lartë është kushtetues ose jo. Ndërkohë që qëndrime të tilla formale të Gjykatës Kushtetuese bëjnë që çështjet të rikthehen në Gjykatën e Lartë, ku shqyrtohen sërish në dhomën e këshillimit dhe ku riparohen vetëm aspektet

formale të vendimit, çka bën që ato të rikthehen në Gjykatën Kushtetuese me të njëjtat pretendime të ngritura më parë, por që nuk kanë marrë përgjigje nga asnjë gjykatë.

7. Për pasojë, edhe në rastin në fjalë, vlerësoj se Gjykata Kushtetuese, kur ka marrë në shqyrtim kërkesën e parë të paraqitur nga palët (vendimi nr. 26/2013), nuk duhej të ishte ndalur vetëm në shfuqizimin e vendimit për mungesë të shkaqeve, por duhej të kishte evidentuar edhe shkaqet për të cilat procesi i zhvilluar në atë gjykatë ishte jokushtetues, në mënyrë që të evitonte një vendimmarrje tjetër formale të dhomës së këshillimit. Duke qenë se pretendimet e ngritura në kërkesë janë të tilla që i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, i takonte Gjykatës së Lartë që, në ushtrim të funksionit të saj si gjykatë e ligjit, të interpretonte dispozitat procedurale, që rregullojnë dhe përcaktojnë forcën e një vendimi të formës së prerë, dhe ato ligjore, që parashikojnë fuqinë prapavepruese të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, për të arritur në përfundimin nëse në rastin në fjalë jemi para cenimit të parimit të sigurisë juridike.

8. Megjithatë, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk u dha përsëri përgjigje pretendimeve të ngritura nga kërkesit në rekurs, për arsye që kanë të bëjnë me ekonominë gjyqësore dhe evitimin e një kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit gjyqësor, i bashkohem qëndrimit të shumicës për t'u dhënë vetë përgjigje këtyre pretendimeve.

9. Kërkesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar, mes të tjerash, se pas dhënies së vendimit nga gjykata e apelit dhe gjatë shqyrtimit të çështjes së tyre në Gjykatën e Lartë, kishte hyrë në fuqi vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili shfuqizoi dispozitën e ligjit për KKKP-në, që parashikonte kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të rishikuar vendimet e KKKP-së të formës së prerë.

10. Edhe pse i bashkohem qëndrimit të shumicës se në rastin konkret nuk ka cenim të parimit të sigurisë juridike, vlerësoj se argumentet e dhëna prej saj nuk janë të mjaftueshme. Në rastin konkret, shumica nuk duhej ta kishte trajtuar këtë pretendim në këndvështrim të respektimit të fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, por në këndvështrim të respektimit të parimit të ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit dhe atë të zbatimit të ligjit material e procedural në kohë.



Duke qenë se çështje të tilla të ngjashme mund të bëhen sërish objekt i kontrollit nga kjo Gjykatë, vlerësoj se ajo duhet të ishte ndalur në evidentimin e disa parimeve të përgjithshme të së drejtës.

11. Gjykata ka theksuar se parimi i përgjithshëm që vepron në sistemin e të drejtës është ai i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit. Përfundimi që bëhet nga rregulli i përgjithshëm, duke i dhënë fuqi prapavepruese vetëm ligjit penal që favorizon pozitën e të pandehurit, synon t'i përgjigjet në mënyrë sa më të shpejtë e të përshtatshme vlerësimeve të ligjvënësimit mbi rrezikshmërinë shoqërore të veprimeve apo mosveprimeve të caktuara, si dhe të subjekteve që i kanë kryer apo mund t'i kryejnë ato në të ardhmen. Parimi kushtetues i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues duhet respektuar nga të gjitha gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjafton që fati i çështjes të mos jetë vendosur ende përfundimisht prej tyre. Pra, sigurisht që ky parim duhet të respektohet edhe në gjykimin që mund të zhvillohet në Gjykatën e Lartë, sepse është pikërisht kjo Gjykatë që kontrollon mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr. 35, datë 20.12.2005 dhe nr. 14, datë 17.4.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Ligji nuk ka fuqi prapavepruese dhe ky është rregulli i përgjithshëm. Fuqia prapavepruese e normave juridike si përfundim nuk mund dhe nuk duhet të ketë efekt (zbatim) të gjerë, pasi do të shkaktonte pasiguri në marrëdhëniet juridike. Kjo pasiguri do të lindte për shkak se te subjektet e këtyre marrëdhënieve do të krijohej dyshimi se sjelljet e tyre, që janë në pajtim me normat juridike në fuqi, me norma të ardhshme që do të kenë fuqi prapavepruese, mund të konsiderohen të kundërligjshme dhe mbi to mund të zbatohen, për këtë shkak, edhe sanksione.

13. Si përfundim fuqia prapavepruese e vendimit të Gjykatës Kushtetuese është parashikuar në nenin 76/b të ligjit organik të saj, sipas të cilit "... 2. *Vendimi ka fuqi prapavepruese vetëm: ... b) ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat, derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë;...*" Ligji organik i gjykatës e lidh zbatimin me fuqi prapavepruese të vendimeve të saj me marrjen formë të prerë të vendimit.

14. Në legjislacionin tonë gjejmë të përdorur si termin i "formës së prerë", ashtu edhe atë

"përfundimtar". Përdorimi i shprehjes "i formës së prerë" nuk ka qenë i rastësishëm dhe ai lidhet me natyrën e gjykimit në gjykatat e faktit, që është e ndryshme ajo që zhvillohet në gjykatën e ligjit. Gjykata ka theksuar se gjykimi në Gjykatën e Lartë dallon nga ai në gjykatat e faktit dhe se Gjykata e Lartë ka kompetenca të kufizuara në shqyrtimin e çështjeve, duke qenë kompetente për të vlerësuar nëse gjykatat më të ulëta kanë zbatuar drejt ligjin material e procedural në fuqi.

15. Nëse do t'i referohemi konceptit që kanë përdorur kodet e procedurës për formën e prerë, atëherë ky vendim i përket gjykatës së apelit, ku dhe përfundon gjykimi në fakt i çështjes. Në nenin 451 të KPC-së parashikohet: "*Vendimi i gjykatës merr formë të prerë kur "... ç) vendimi i gjykatës është lënë në fuqi, ndryshuar ose është pushuar gjykimi në shkallë të dytë.*" Në përputhje me parashikimet e neneve 449 dhe 451 të KPC-së, rezulton se vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përfundim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar (*shih vendimet nr. 43, datë 19.7.2012, nr. 56, datë 21.12.2012 dhe nr. 59, datë 24.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Kodet e procedurës e lidhin marrjen formë të prerë të vendimit me vendimin e gjykatës së apelit, ku edhe përfundon gjykimi në fakt i çështjes. Sigurisht që në rast se do të dëshirohej të mbahej një qëndrim i ndryshëm, atëherë ligji organik do të kishte përdorur termin "përfundimtar", të cilin e gjejmë në rastin e parashikimit të nenit 131/f të Kushtetutës dhe që lidhet me juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

16. Edhe nëse iu referohemi vendimeve të GJEDNJ-së në çështjet Gjyli kundër Shqipërisë dhe Rrapo kundër Shqipërisë, të cilat janë ndalur në interpretimin e termit "formë e prerë" sipas dispozitave procedurale, rezulton se në rastin e parë (Gjyli) nga ana e Qeverisë është pretenduar mosshërimi i mjeteve ligjore dhe për këtë qëllim GJEDNJ-ja është ndalur në interpretimin e këtij termi (linjë që është në përputhje me qëndrimin e Gjykatës tonë në lidhje me nenin 131/f të Kushtetutës). Kurse në rastin e dytë (Rrapo) jemi përpara pretendimit të qeverisë për moszbatimin e një mase të përkohshme të dhënë nga vetë GJEDNJ-ja ndaj shtetit shqiptar dhe për t'i dhënë përgjigje këtij pretendimi, GJEDNJ-ja është ndalur në interpretimin e po të njëjtut koncept. Ky



interpretim i GJEDNJ-së nuk është i ndryshëm nga ai që bën Gjykata Kushtetuese në lidhje me shterimin e mjeteve për t'iu drejtuar asaj në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, për pretendimet për cenimin e të drejtës për një proces të rregullt.

17. Përveç parimit të mësipërm, një parim tjetër i zbatueshëm në rastin konkret, është edhe ai zbatimit të ligjit në kohë. Sipas këtij parimi, në të drejtën materiale zbatohet ligji në fuqi në momentin e lindjes së mosmarrëveshjes, kurse në të drejtën procedurale, ndryshe nga ajo materiale, ligji i ri ka fuqi edhe për çështjet që janë në gjykim, me përjashtim të rastit kur vetë ai shprehet ndryshe, duke parashikuar dispozita procedurale kalimtare. Për pasojë, në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje në gjykatat e faktit (shkallë të parë dhe në apel), ligji i zbatueshëm parashikonte kompetencën e Drejtorit të Përgjithshëm të AKP-së për të shfuqizuar vendimet e KKKP-ve. Sigurisht që ky ligj prezumohet kushtetues derisa vendimi i Gjykatës Kushtetuese nuk ka hyrë në fuqi. Është mbi bazën e këtij ligji që gjykatat kanë zgjidhur mosmarrëveshjen e paraqitur para tyre dhe është mbi këtë bazë ligjore që vendimi ka marrë formë të prerë. Në kushtet kur Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, ka detyrimin të kontrollojë mënyrën se si është zbatuar ligji i kohës nga gjykatat e faktit, ajo nuk mund të japë një zgjidhje ndryshe të çështjes, duke zbatuar një ligj të ndryshëm nga ai i kohës kur është zgjidhur mosmarrëveshja.

18. Për sa më sipër, vlerësoj se në rastin konkret gjen zbatim parimi i ndalimit të fuqisë prapavepruese të ligjit dhe parimi i zbatimit të tij në kohë. Bazuar në këto dy parime mbështes qëndrimin tim për rrëzimin e kësaj kërkesë.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Kërkuesit kanë pretenduar, ndër të tjera, se është cenuar siguria juridike, pasi në kohën e gjykimit në Gjykatën e Lartë (GJL), kompetenca e rishikimit të vendimeve të KKKP-së nga drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së ishte shfuqizuar si antikushtetuese dhe GJL-ja ka lejuar lënien në fuqi

të vendimit të apelit, ndërkohë që ky i fundit është i mbështetur mbi një dispozitë ligjore të shfuqizuar si antikushtetuese. Shumica e ka vlerësuar të pabazuar këtë pretendim të kërkuesve. Duke iu referuar nenit 76/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ajo e ka konsideruar vendimin e gjykatës së apelit si vendim të formës së prerë. Sipas shumicës, kompetenca e drejtorit të AKKP-së nuk ishte deklaruar antikushtetuese në kohën e gjykimit në apel dhe në datën e shpalljes së vendimit nga gjykata e apelit, kjo e fundit ka zbatuar ligjin e kohës që ka qenë në fuqi (*shih prg.23-24 të vendimit*).

3. Shumica qëndrimin e saj e bazon në interpretimin që i ka bërë nenit 76/2/b i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”. Sipas kësaj dispozite, vendimi i Gjykatës Kushtetuese (GJK) që ka shfuqizuar një ligj apo akt normativ si të papajtueshëm me Kushtetutën ka fuqi prapavepruese “ndaj çështjeve që shqyrtohen nga gjykatat derisa vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë”. Për të sqaruar kuptimin e termave “vendimet e tyre nuk kanë marrë formë të prerë”, shumica u është referuar parashikimeve të neneve 449 dhe 451 të KPC-së dhe ka konkluduar se vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë dhe ushtrimi i rekursit ndaj tij pranë Gjykatës së Lartë nuk ka efekt pezullues, me përjashtim të rasteve kur kjo e fundit vendos pezullimin e vendimit të rekursuar në bazë të nenit 479 të KPC-së. Ky konkluzion, për rrjedhojë, të çon në qëndrimin se vendimi i GJK-së, që ka shfuqizuar një ligj si antikushtetues, nuk ka fuqi prapavepruese ndaj çështjes që gjykohet në GJL, dhe se kjo e fundit kontrollon vetëm se si është zbatuar ligji i kohës gjatë gjykimit në apel, pavarësisht se ky ligj, pas dhënies së vendimit në apel, mund të jetë shfuqizuar si antikushtetues. Mendojmë se termi “vendimi gjyqësor i formës së prerë”, në kuptim të nenit 76/2/b të ligjit organik të GJK-së nr. 8577, të përmendur më sipër, duke marrë në konsideratë disa standarde kushtetuese të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e GJEDNJ-së, duhet të interpretohet në kuptimin e “vendimit përfundimtar”, i cili barazohet me kuptimin e termit “gjë e gjykuar”. Këtë konkluzion e mbështesim në argumentet që jepen më poshtë.



4. Siç është shprehur edhe shumica, zbatimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është një detyrim kushtetues për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht në lidhje me forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë dhe gjykatat. Si të tilla, ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare (*shih prg. 20 të vendimit*).

5. Në bazë të nenit 145 të Kushtetutës: “Kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato. Në këtë rast, ata pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha gjykatat.” Kjo dispozitë kushtetuese, në funksion të parimit të kushtetutshmërisë dhe shtetit të së drejtës, e shtrin detyrimin mbi të gjitha gjykatat, duke përfshirë edhe Gjykatën e Lartë. Kjo do të thotë se GJL, nëse gjatë kontrollit që ushtron ndaj vendimit të gjykatës së apelit, konstaton se ligji, mbi bazën e të cilit është bazuar vendimi i apelit, është antikushtetues, ajo ka detyrimin për të mos e zbatuar këtë ligj.

6. GJL-ja, bazuar në nenin 145 të Kushtetutës, me vendimin e datës 26.3.2009, ka vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatën Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së neneve 16 dhe 18 të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar, lidhur me kompetencën e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të KKKP-ve. GJK-ja, me vendimin nr. 27/2010, e ka pranuar kërkesën e GJL-së, pasi e ka vlerësuar si antikushtetuese kompetencën e mësipërme të drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së. Në këtë vendim, Gjykata, ndër të tjera, e ka legjitimuar GJL-në, duke u shprehur: “Në lidhje me legjitimitimin e Gjykatës së Lartë (në vijim gjykata referuese), Gjykata Kushtetuese çmon se ky organ, në përputhje me nenet 134/1, germa “d” dhe 145/2 të Kushtetutës, mund të ushtrrojë kontrollin e kushtetutshmërisë së normave, me kusht që kushtetutshmëria e tyre të jetë *conditio sine qua non* për zgjidhjen e çështjes konkrete. [...] Nëse gjykata referuese ka bazë të arsyeshme të vlerësojë se zgjidhja e çështjes nga ana e saj, duke aplikuar ligjin konkret, mund të çojë në cenimin e të drejtave kushtetuese të shtetasve, atëherë

ajo autorizohet nga urdhërimi i normës kushtetuese që të referojë çështjen për zgjidhje të problemit të kushtetutshmërisë pranë Gjykatës Kushtetuese”. Nëse do të niseshim nga interpretimi se GJL-ja në çështjet civile kontrollojnë vetëm se si është zbatuar ligji i kohës gjatë gjykimin në apel, pavarësisht se ky ligj pas dhënies së vendimit në apel mund të shfuqizohet si antikushtetues, atëherë kjo mund të çojë në moslegjitimitimin e GJL-së për vënien në lëvizje të GJK-së nëpërmjet rrugës incidentale, sipas nenit 145/2 të Kushtetutës, për arsye të mosplotësimit të kushtit për lidhjen e drejtpërdrejtë të zgjidhjes së çështjes me vendimmarrjen kushtetuese.

7. Në jurisprudencën e saj Gjykata është shprehur se në harmoni me parimin e sigurisë juridike, ligji procedural civil ka sanksionuar edhe parimin e gjësë së gjykuar (*res judicata*), parim i cili pengon dhënien e çdo vendimi të ri mbi atë që është gjykuar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe GJEDNJ-ja, e cila ka nënvizuar se parimi në bazë të të cilit një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar dhe zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve me një efekt përfundimtar, është një element themelor i gjykimin të drejtë që garantohet nga neni 6 i Konventës në çështjet civile (*shih çështjen Kehaya dhe të tjerë kundër Bullgarisë, datë 12.1.2006*).

8. Në lidhje me konceptin e “vendimit përfundimtar të formës së prerë”, GJEDNJ-ja është shprehur se sipas raportit shpjgues të Protokollit nr 7, një “vendim është përfundimtar/final” nëse, sipas kuptimit tradicional, ka fituar fuqinë e gjësë së gjykuar (*res judicata*). Ky është rasti kur ai është i parevokueshëm, që do të thotë, kur nuk ka mjete të tjera të zakonshme në dispozicion ose kur palët i kanë konsumuar të tilla mjete, ose kanë lejuar që afati kohor të përfundojë pa i përdorur ato (*shih çështjet Käiveri kundër Finlandës, 10 shkurt 2015 dhe Nikitin kundër Rusisë, 20 korrik 2004*)².

9. Në rastin konkret, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se vendimi i apelit është përfundimtar, i paankimueshëm, përderisa kërkuessit kishin mjet tjetër të zakonshëm në dispozicion (rekursin), të cilin e kanë shfrytëzuar brenda afateve ligjore. Ndryshe nga shumica, vlerësojmë se në çështjen në shqyrtim gjen aplikim përjashtimi i parashikuar në

² Përkthim i Gjykatës



nenin 76/b të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”.

10. Siç u përmend edhe më sipër, Gjykata, me vendimin nr. 27/2010, ka shpallur si të papajtueshme me Kushtetutën kompetencën e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shqyrtuar kryesisht vendimet e dhëna nga KKKP-ja. Ajo është shprehur në këtë vendim se kompetenca e drejtorit të AKKP-së për shfuqizimin e vendimeve të ish KKKP-ve, të cilat kanë marrë formë të prerë, përbën cenim të parimit të sigurisë juridike, pasi zbatimi nga një organ administrativ si AKKP-ja i parimeve të revokimit dhe shfuqizimit të akteve të ish-KKKP-ve, që nuk janë akte tipike administrative të një organi tipik administrativ, konsiderohet si ndërhyrje e pajustificuar mbi të drejtat civile të shtetasve. Gjykata ka arsyetuar se vendimet e AKKP-së për të shfuqizuar vendimet e KKKP-së nuk respektojnë parimin e sigurisë juridike, pasi nuk mund të cenohet situata juridike dhe faktike e palëve e krijuar nga vendimi gjyqësor apo *quasi* gjyqësor i formës së prerë.

11. Nga shqyrtimi i akteve të dosjes rezulton se kërkuesit e kanë parashtruar në rekurs faktin e shpalljes si antikushtetuese të kompetencës së drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shqyrtuar e shfuqizuar kryesisht vendime të KKKP-së, por kjo nuk është përfshirë në shkaqet e rekursit në vendimin nr. 00-2014-55, datë 22.1.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Çështja e sigurisë juridike është evidentuar edhe nga Gjykata në vendimin e saj nr. 26, datë 24.6.2013, ku është përmendur mosmarrja në konsideratë nga Gjykata e Lartë e vendimit të saj që ka shpallur si antikushtetuese kompetencën e drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së për të shfuqizuar kryesisht vendime të KKKP-së. Megjithatë, edhe pas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Lartë duket se nuk e ka mbajtur parasysh këtë vendim të Gjykatës.

12. Vendimi nr. 27/2010 i Gjykatës nuk ishte shpallur ende kur çështja konkrete ka qenë duke u gjykuar në gjykatën e apelit e deri në momentin e dhënies së vendimit nga kjo gjykatë (15.2.2010), por kur çështja është shqyrtuar në GJL (28.06.2012 dhe 22.1.2014) ky vendim i Gjykatës kishte hyrë në fuqi. Megjithëse GJL-ja ka detyrimin të zbatojë vendimet e Gjykatës Kushtetuese, ajo ka lejuar në

rastin konkret cenimin e parimit të sigurisë juridike duke mos kontrolluar në lidhje me shtrirjen e efekteve juridike dhe fuqisë prapavepruese të vendimit nr. 27/2010. Pikërisht këtë lloj kontrolli duhej të bënte Gjykata e Lartë, e cila e ka për detyrë të garantojë zbatimin korrekt të ligjit procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Rreziku i mosrespektimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese lidhet jo vetëm me faktin se një individ të caktuar i cenohet e drejta kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por edhe me faktin se preket vetë thelbi i funksionimit të shtetit të së drejtës (*shih vendimin nr. 20, 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Për pasojë, çmujmë se GJL-ja, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit për kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat e të gjitha niveleve, nuk ka zbatuar vendimin e Gjykatës në çështjen objekt gjykimi.

14. Si përfundim, për sa më sipër, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike është i bazuar dhe Gjykata duhej të kishte vendosur shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi

VENDIM

Nr. 18, datë 14.04.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i	“
Sokol Berberi	anëtar i	“
Vitore Tusha	anëtare e	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“
Gani Dizdari	anëtar i	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“
Fatos Lulo	anëtar i	“

me sekretare Blerina Basha, në datën 03.02.2015 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 68/35 Akti, që i përket:



KËRKUES: Dritan Fani

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 713, datë 4.7.2012 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 44, datë 26.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2 dhe 134 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatos Lulo; mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që kërkon pranimin e kërkesës; njoftoi subjektin e interesuar, i cili nuk paraqiti prapësime, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 110, datë 20.7.2004, ka vendosur, ndër të tjera, deklarimin fajtor të kërkuesit për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të Kodit Penal (*KP-ja*), dhe dënimin e tij me 13 vjet burgim. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 156, datë 11.3.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 85, datë 17.2.2006, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP-ja*).

2. Ndërkohë që vuante dënimin, kërkuesi, me vendimin nr. 59, datë 03.05.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, është deklaruar përsëri fajtor për një ngjarje tjetër të kryer para dhënies së vendimit të parë, për veprën penale të vjedhjes me armë në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 140 dhe 25 të KP-së, dhe është dënuar me 12 vjet burgim.

3. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 45, datë 25.1.2008 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

4. Në këto kushte, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 55/2 dhe 56 të KP-së, ka kërkuar bashkimin e dënimeve penale të

dhëna ndaj kërkuesit me vendime të formës së prerë, si dhe caktimin e një dënimi përfundimtar.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin, me vendimin nr. 482/64, datë 13.5.2009, ka vendosur pranimin e kërkesës, bashkimin e dënimit të ri prej 12 vjetësh, të dhënë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, nr. 59, datë 03.05.2007, me pjesën e mbetur të dënimit të mëparshëm. Dënimin përfundimisht të kërkuesit me një dënim të vetëm prej 13 vjetësh. Gjykata ka caktuar, gjithashtu, se vuajtja e dënimit fillon në datën e arrestimit (fillestar) të kërkuesit, pra më 28.11.2002. Vendimi në fjalë ka marrë formë të prerë, pa u ankimuar nga asnjëra prej palëve ndërgjyqëse.

6. Në vitin 2012, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kurbin, bazuar në nenet 114 dhe 385 të KPP-së, i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin për ndreqjen e gabimit material të vendimit nr. 482/64, datë 13.5.2009. Kjo e fundit, me vendim nr. 44, datë 26.3.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës: ndreqjen e pjesës urdhëruese të vendimit penal nr. 482/64, datë 13.05.2009, duke caktuar si datë të fillimit të vuajtjes së dënimit, atë të kërkesës për bashkimin e dënimeve, pra më 24.3.2009.

7. Kundër vendimit të ndreqjes së gabimit material ka paraqitur ankim kërkuesi dhe Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 713, datë 4.7.2012, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 44, datë 26.3.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.

8. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2013-5, datë 10.01.2013, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së.

9. Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 13, datë 17.03.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2013-5, datë 10.01.2013 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit.

II

11. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke pretenduar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore objekt kërkese, sepse këto vendime i kanë cenuar të drejtën për një proces të



rregullt ligjor në aspektet e mëposhtme:

11.1 Vendimet e gjykatave të faktit janë të paarsyetuara. Këto vendime rezultojnë të paqarta dhe nuk ndjekin një linjë logjike që lidh argumentet me pjesën urdhëruese të vendimit.

11.2 Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit është rezultat i një veprimi arbitrar dhe të kundërligjshëm.

11.3 Është cenuar parimi i sigurisë juridike, pasi në vendimin nr. 44, datë 26.3.2012 nuk ka ndreqje të gabimit, por ndryshim të vendimit të formës së prerë, pasi në këtë ndreqje vendimi kërkuesi duhet të vuajë 9 vjet burg më shumë se masa e dënimit e caktuar me vendimin nr. 482/64, datë 13.05.2009.

11.4 Është shkelur barazia para ligjit (*neni 18 i Kushtetutës*). Kjo pozitë e pabarabartë e kërkuesit konsiston në faktin se vuajta e dënimit për të duhej të fillonte nga dita e arrestimit dhe jo nga data e bashkimit të dënimeve, sikundër kanë disponuar gjykatat.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesit

12. Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligj. Në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, individi, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave të tij, mund ta paraqesë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese brenda 2 vjetëve nga data e njofimit të vendimit të fundit të organit përkatës shtetëror. Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se vendimi më i fundit në kohë është vendimi nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (*dhomë këshillimi*).

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuesit në thelb janë të njëjta me pretendimet e parashtruara dhe të administruara në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese. Në këto kushte, Gjykata merr në analizë vetëm pretendime të reja e të pashqyrtuara më parë prej saj. Për rrjedhojë, analiza në vijim përqendrohet në vlerësimin e pretendimeve që lidhen me respektimin e *standardit kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore* gjatë

rigjykimit të çështjes nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.

B. Për pretendimin për cenimin e *standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë*

14. Kërkuesi ka pretenduar se vendimet e gjykatave të faktit, siç është konstatuar edhe nga Gjykata Kushtetuese, janë të paarsyetuara, për rrjedhojë Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen në seancë gjyqësore. Për më tepër, edhe pse Gjykata Kushtetuese, bazuar në këtë argument, vendosi pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-1133, datë 10.1.2013 të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, çështja përsëri u gjykua në dhomë këshillimi, duke vendosur mospranimin e rekursit.

15. E drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 dhe neni 142/1 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.2.2012, nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 25, datë 10.6.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në



gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011, nr. 23, datë 4.11.2008, nr. 11, datë 2.4.2008 dhe nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata është shprehur edhe lidhur me zbatimin e këtij detyrimi nga Gjykata e Lartë për vendimet e dhëna prej saj në dhomë këshillimi dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë

vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 19, datë 19.7.2005 dhe nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në rastin konkret, siç rezulton qartësisht nga përmbajtja e vendimit nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata vëren se çështja është shqyrtuar në dhomën e këshillimit duke vendosur mospranimin e rekursit.

21. Për një analizë në vazhdimësi të çështjes, Gjykata u përmbahet qëndrimeve të shprehura më parë në lidhje me këtë çështje në vendimin nr. 13, datë 17.3.2014, duke ritheksuar faktin se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe nenin 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet *e forcës së ligjit*. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Në respekt të doktrinës dhe të jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se efekti detyrues që pasqyrohet mbi argumentet thelbësore të vendimit të saj përbëjnë edhe një *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka theksuar se nga standardi i detyrimit të zbatimit të vendimmarrjes kushtetuese nuk mund të bëjë përjashtim as vet Gjykata Kushtetuese (*shih vendimet nr. 5, datë 7.2.2001; nr. 14, datë 3.6.2009 dhe nr. 21, datë 29.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih vendimet nr. 5, datë 7.2.2001 dhe nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 Gjykata ka çmuar se “në kushtet kur janë të



pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave procedurale që kanë ndikuar në dhënien e vendimit, si dhe të parimeve themelore të procesit të rregullt ligjor, Gjykata e Lartë duhet të mbante një qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga kërkuesi, si në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, ashtu edhe në kontrollin e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta. ... Mungesa e qartësisë së vendimeve të gjykatave të faktit përbën një të metë të pakapërvyeshme të përmbajtjes së secilit prej këtyre vendimeve dhe të arsyetimit të gjykatës. Gjykata vëren se kjo e metë e vendimeve të gjykatave të faktit ka të bëjë me probleme të interpretimit dhe të zbatimit të ligjit që lidhen me zgjidhjen e çështjes konkrete, e cila nuk është korrigjuar nga Gjykata e Lartë, pasi ajo nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit edhe pse shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuesi janë shoqëruar me cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuesit, që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes.

24. Në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014, Gjykata ka vlerësuar se kërkuesit i janë cenuar të drejtat e veta kushtetuese. Në këto kushte, ky fakt nuk mund të anashkalohet dhe t'i nënshtrohet një procesi vlerësimi nga Gjykata e Lartë, e cila ka për detyrë të garantojë zbatimin korrekt të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.

25. Duke konsideruar sa më sipër, Gjykata e shih me vend t'i përmbahet vendimit nr. 13, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese për të gjitha çështjet e analizuar në funksion të këtij gjykimi. Gjykata nuk identifikon asnjë arsye të rëndësishme e cila mund të shërbejë për ndryshimin e konkluzioneve të arritura në këtë vendim, për sa kohë kushtet dhe rrethanat e çështjes në gjykim nuk kanë ndryshuar.

26. Nisur nga vlerësimi i vendimit nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykata konkludon se në rastin konkret Gjykata e Lartë, edhe pas rigjykimit të çështjes, nuk i ka përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimet e përcaktuara në vendimin nr. 13, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese, për sa kohë pretendimet e kërkuesit në thelb nuk kanë marrë ende përgjigje të shprehur. Në këto kushte, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë edhe efektin detyrues të vendimeve të saj, të shtjelluar më lart, vlerëson se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Një zgjidhje e

ndryshme nga sa ka vendosur Gjykata në vendimin nr. 13, datë 17.3.2014 do të ishte antikushtetuese, pasi nuk do të respektohej një akt parësor i nxjerrë pikërisht nga një burim parësor siç është Gjykata Kushtetuese (shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

27. Si përfundim, Gjykata çmon se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesit në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "P", dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe 77 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash³,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-1133, datë 11.07.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari

Anëtarë kundër: Sokol Berberi, Altina Xhoxhaj, Fatos Lulo

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pjesërisht pretendimet e kërkuesit Dritan Fani duke shfuqizuar vendimin nr. 00-2014-1133, datë 11.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), me arsyetimin se ky vendim nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, pasi nuk ka reflektuar vendimarrjen e kësaj Gjykate,

³ Gjyqtari V. Kristo votoi për pranimin tërësisht të kërkesës; Gjyqtarja V. Tusha votoi edhe për shfuqizimin e vendimit të apelit.



konkretisht të vendimit nr. 13, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

2. Shumica, në linjë me jurisprudencën e kësaj Gjykate (*shih vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*), ka argumentuar se zbatimi i detyrueshëm i vendimeve të saj është i garantuar nga Kushtetuta, e cila në nenin 132 dhe 145 të saj sanksionon shprehimisht këtë koncept kushtetues. Vendimet e Gjykatës kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet *e forcës së ligjit*. Ndikimi i padiskutueshëm i vendimeve të Gjykatës është i tillë që iu imponon të gjitha organeve shtetërore, duke mos përjashtuar as gjykatat, fuqinë detyruese të arsyetimit të vendimit të saj. Arsyetimi që përdor Gjykata në vendimet e saj ka forcën e ligjit, çka buron nga autoriteti i këtij organi për të thënë fjalën e fundit në çështjet për të cilat të tjerët tashmë janë shprehur. Çdo qëndrim i kundërt krijon një precedent të rrezikshëm në marrëdhëniet institucionale (*shih paragrafët 21-22 të vendimit*).

3. Pavarësisht se pajtohem me vendimin e shumicës, çmoj se kërkesa duhej pranuar në tërësinë e saj, duke shfuqizuar të gjitha vendimet gjyqësore të kundërshtuara. Për këtë arsye e shoh me vend të shprehem me mendim paralel.

4. Sikurse vërehet edhe në mendimin e shumicës, kërkuesi Dritan Fani, pas shterimit të mjeteve të juridiksionit të zakonshëm, i është drejtuar kësaj Gjykate me pretendimin për cenim të procesit të rregullt gjyqësor, për shkak të gabimit në mënyrën e bashkimit të dënimeve në ngarkim të tij. Kjo e fundit, me vendimin nr. 13, datë 17.3.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe ka arritur në përfundimin se në procesin e zhvilluar ndaj tij ka pasur cenim të nenit 42 të Kushtetutës⁴. Pas këtij

⁴ Në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 Gjykata është shprehur se “vendimet e gjykatave të faktit nuk kanë arsyetuar me qartësi lidhur me këto dy aspekte të bashkimit të dënimeve, me momentin që kërkuesi ka kryer veprën e dytë penale, i cili përcakton dhe mënyrën e llogaritjes së vuajtjes së dënimit përfundimtar .. si dhe ... në lidhje me kohën që të pandehurit i ngelet akoma për të vuajtur. Këto të meta nuk janë riparuar as nga Gjykata e Lartë, për më tepër kur kërkuesi ka pretenduar se në kundërshtim me nenin 55/2 të KP-së, është kapërcyer kufiri më i lartë i parashikuar për llojin e dënimit të dhënë kërkuetit (dënimi maksimal i parashikuar në nenin 140 të KP-së është 20 vjet burgim). (...) Kjo e metë, gjithashtu, bën ndesh me thelbin e së drejtës, për faktin se vendimet e gjykatave të faktit të lartpërmendura, duke korrigjuar pas një harku kohor prej 3 vjetësh një vendim të formës së prerë, kanë rënduar pozitën e të

vendimi, Gjykata e Lartë, të cilës i është ridrejtuar kërkueti, duke mos marrë parasysh vendimin e lartpërmendur të Gjykatës, ka vendosur mospranimin e kërkesës së tij, me arsyetimin se gjykatat e faktit nuk janë shprehur për themelin e vendimeve të mëparshme të bashkimit të dënimeve, por për ndreqjen e gabimit material që është verifikuar në të (datën e fillimit të llogaritjes së vendimit).

5. Në zbatim të jurisprudencës së lartpërmendur të Gjykatës jam i mendimit se garantimi i zbatimit të ligjit penal, procedural dhe material nga të gjitha gjykatat, në përputhje me Kushtetutën dhe vendimet e kësaj Gjykate, është detyrë e Gjykatës së Lartë, dhe për atë lind detyrimi që të riparojë pasojat e shkeljeve të konstatuara nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese. Nga ana tjetër, mendoj se në rastin konkret, në kushtet kur Gjykata e Lartë nuk ka reflektuar mbi vendimmarrjen e kësaj Gjykate, nuk ka asnjë pengesë që të pranohet në tërësi kërkesa në shqyrtim, duke u shfuqizuar të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna ndaj kërkuetit, dhe çështja të rikthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, aty ku fillojnë edhe shkeljet e konstatuara nga Gjykata në vendimin nr. 13, datë 17.03.2014 sepse ankimi kushtetues, në linjë me jurisprudencën kushtetuese dhe atë të GEJDNJ-së, është mjeti efektiv për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur dhe rregullimin e pasojave të shkeljes.

6. Nëse do t'i referoheshim për analogji edhe vendimeve të GJEDNJ-së, sipas kërkesave të nenit 46 të KEDNJ-së, një shtet palë, për të cilin GJEDNJ-ja është shprehur se ka shkelur Konventën ose Protokollet e saj, ka detyrimin që të veprojë në përputhje me vendimin e asaj gjykate. Shteti ka detyrimin jo vetëm të shlyejë dëmin material ndaj personave të interesuar, por edhe të marrë masa individuale dhe/ose, nëse është e përshtatshme, masa të përgjithshme në rendin e vet ligjor që t'i japë fund shkeljes së gjetur nga gjykata dhe të rregullojë pasojat e shkeljes, me qëllimin që kërkuesi të rikthehet, për aq sa është e mundur, në gjendjen që ishte para se të bëhej shkelja (*vendimi në çështjen Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, nr. 39221/98 dhe 41963/98, § 249, ECHR 2000-VIII dhe*

pandehurit, i cili kishte krijuar pritshtëri të ligjshme në lidhje me kohëzgjatjen e dënimit përfundimtar” (shih paragrafët 24 – 25 të vendimit).



Assanidze kundër Gjeorgjisë, nr. 71503/01, § 198, ECHR 2004-II).

7. Në vendimet e saj, GJEDNJ-ja ka shprehur parimin e njohur të së drejtës ndërkombëtare *restitutio in integrum*, i cili është përdorur shpesh nga Komiteti i Ministrave në rezolutat e tij. Lidhur me mënyrën se si do të zbatojnë detyrimet e parashikuara në nenin 46 të Konventës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, shtetet palë të KEDNJ-së gëzojnë diskrecion dhe KEDNJ-ja nuk përmban dispozita që t'u imponojë palëve kontraktuese detyrimin për të parashikuar në ligjin e brendshëm rishqyrtimin apo rihapjen e procedimeve. Gjithsesi, ekzistenca e mundësive të tilla, në rrethana të veçanta, ka provuar të jetë e rëndësishme dhe në disa raste i vetmi mjet për të arritur *restitutio in integrum* (shih çështjen *Xheraj kundër Shqipërisë, vendimi i datës 14.12.1998, si dhe vendimin nr. 45, datë 1.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Edhe Gjykata, në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të KEDNJ-së, i cili sanksionon termin “ankim efektiv”, ka theksuar se është e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetesh, sipas rastit, janë në dispozicion të individit dhe nëse ato i krijojnë atij mundësi reale për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në mënyrë efektive. Në këtë drejtim është evidentuar se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv, duhet të jetë i përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (shih vendimet nr. 9, datë 15.3.2013; nr. 27, datë 20.6.2007; nr. 6, datë 31.3.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

9. Nisur nga sa më lart, çmoj se në rastin konkret shqyrtimi në themel i çështjes nga Gjykata do të përbënte mjetin efektiv ligjor dhe të mjaftueshëm për të vënë në vend të drejtat e shkelura, të konstatuara në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Rrjedhimisht, jam i mendimit se Gjykata duhet ta pranonte në tërësi kërkesën e paraqitur nga Dritan Fani dhe të shfuqizonte të gjithë vendimet objekt kërkesë.

10. Nga ana tjetër, vendimi i shumicës për shfuqizimin vetëm të vendimit të Gjykatës së Lartë bie ndesh edhe me disa parime të tjera të procesit të rregullt ligjor të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese. Rikthimi i çështjes për shqyrtim përsëri në Gjykatën e Lartë do të cenonte një element të rëndësishëm të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pikërisht kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit. Prandaj, vlerësoj se interpretimi i shumicës nuk është as në funksion të parimit të drejtësisë efektive.

11. Përfundimisht çmoj se shfuqizimi vetëm i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë jo vetëm që zvarrit një proces të evidentuar tashmë nga kjo Gjykatë si një proces i parregullt ligjor, por nga ana tjetër nuk e identifikon Gjykatën Kushtetuese si një mjet efektiv për individin. Në këto kushte vendimi i shumicës ka më shumë vlerë formale deklarative se sa funksionale.

Anëtarë: Vladimir Kristo

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 276, datë 2.3.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ardjan Gryka, i datëlindjes 1970, si dhe caktimin e shtetasit Bashkim Gryka si kujdestarit për administrimin e pasurisë së tij.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 224 lekë